

8SH-32

P97

Ruzhdi Pulaha

Ndodhi
zë ditës

891.983-32
P 92

RUZHDI PULAH

S

NDODHI TË DITËS

(tregime)

~~afili~~

2971

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

BABALLARËT

— C'fëmijë ke? — pyeti shoferi pa u nisur akoma mirë maqina.

Pasagjeri buzëqeshi:

— Çudi! Kam udhëtuar qindra herë, po ju jeni i pari që pa këmbyer asnje fjalë pyetni drejt e pér fëmijët.

— Sot tërë ditën e ditës vetëm pér fëmijët kam menduar.

— Dy vajza kam.

— E di që nga një anë e kini mirë ju njerëzit me shkollë që s'bëni shumë fëmijë?! Sa më shumë fëmijë, aqë më shumë thasë me halle mbi kurriz.

Pasagjeri përsëri buzëqeshi.

— Po ju sa kini?

— Mos e pyet, gjashtë — i mëshoi zërit shoferi — gjashtë thasë hallesh mbi kurriz... E... shoferit iu zgjidh gjuha...

Pasagjeri ktheu kokën.

— Fejoj djalin e madh, që thua ti.

— Dhe unë po vrisja mendjen të gjeja përse qenkeni veshur me kostum e paskeni vënë kollaro sot. Sesi m'u dukët... Zakonisht shoferët...

— Pa më pyet mua ti, si më duket vetja...
Po ç'ti bëj gruas!? Ja të vishesh ja s'ka... S'kisha
ç'bëja, e vesha. Le po ime bijë më lidhi edhe këtë
kapistall pas gryke — dhe çlirroi kollaren që i
dukej sikur i merrte frymën. — Kur ika më dha
njëqind porosi «Shiko se mos shkosh si gogol atje
e na nxive faqen pastaj... Mos harro të lahash
mirë e mirë, të rruhesh, të llustrosësh këpucët...
të...» Se ç'më tha tjetër... kush e mban mënd!

— Ç'punë të bën djali? — e pyeti pasagjeri.

— Inxhinier.

— Po e fejuara?

— E dashura thuaj, se s'janë fejuar akoma.

— Nejse, njëlloj është...

— Njëlloj po dy hesape... Studente.

— S'e paske me qejf më duket — tha pasa-
gjeri.

— Besa po si pa qejf e kam.

— Dashuria...

— More sytë të nxjerrin me gjithë dashuri...
S'e kam aty. Puna është se na ka ngatërruar me
njerëz që s'na hahet muhabeti... Ti e shikon —
lëshoi timonin dhe ngriti duart. — Shofer hesapi.
Kurse ai vete ngatërrohet me të bijën e një pro-
fesori të madh. Hane Shan e hane Bagdad... Unë
doja që të merrte ndonjë të dorës sonë, që të na
puqeshin fitilat. Ç'ti them profesorit unë? Ai të
më flasë pér libra e pér kushedi se çfarë, e unë
të rri si hu gardhi...

— Rëndësi ka që djali juaj me vajzën e tij
të duhen e të krijojnë një familje të mirë...

— Ashtu hë? Po unë që u robtova tërë jetën
gjersa e bëra kaqë, ç'ti gëzoj djalit? Siç e sheh

unë jam tërë jetën udhëtar. Ja, më zu nata në Tiranë, pse të shkoj në hotel unë kur kam krushkun. Po të kisha një krushk kështu si veten, që të shtroheshim këmbë kryq e të kishin hesapet pesë e pesë. Po te profesori nuک shkel unë... Ti e kuption vetë si puqet... (shoferi përsëri lëshoi timonin dhe fërkoi dy gishtat tregues). Mua më pëlqen ta pi përmatë nga një gotë raki me një qepë, e me një copë djathë e me një piperkë bukove, kështu më shijon mua. Por kur të më vijë profesori në shtëpi s'mund ta nxjerr, kështu që... Ose kur të shkoj unë tek ai... Do të ma mbushin tryezën plot, do të më lëshojnë përpara pirun, thikë e turli takravatesh. Ku jemi ne për ato gjëra, o byrazer. Unë ose do të rri pa ngrënë, o do të fut duart në pjatë, do të marr thelën e do ta ha sipas qejfit tim. Po ata do shtrembërojnë turinjtë. Ç'të bëj unë pastaj? Kështu është puna... Pastaj kushedi ç'mëndjemadh do jetë ai profesori. Nga ata që mezi të flasin me gojë.

Nga toni që u jepte fjalëve shoferi, pasagjeri kuptoi se ai ishte me të vërtetë i mërzitur. Mbasi kaluan një të përpjetë, nën maqinë diç kërciti.

— Ç'pate, o dreq — tha shoferi e mbasi frenoi në anë të rrugës zbriti. I erdhi një herë përqark maqinës, diç kontrolloi me sy e me duar poshtë saj e pastaj shkoi mori disa çelësa në kabinë.

— Janë liruar dadot e ka një xhoko — i tha pasagjerit. Ky nxori një libër nga çanta, që mbante në prehër, e filloi të lexonte. Shoferi u kthyte pas disa minutash. Pasagjeri me ta parë ja dha gazit me të madhe.

— Ç'qënke bërë kështu?

— Hë?

— Kostumin e ke bërë gjithë baltë...

— As që më shkoi ndër mend se ç'kam veshur. S'jam mësuar me këto gjëra... e ti më thua se s'ka gjë që im bir po fejohet me të bijën e profesorit... — Ai u përkul për të vënë çelësat në vendin e vet. Kollarja iu var poshtë e i lëkundej midis gjunjëve si lavjerrës.

— Edhe unë mora mendjen e gruas, — u nxeh me vete dhe pasi e hoqi kollaren e hodhi në një kuti teneqeje ku mbante leckat që fshinte maqinën.

— E po si do t'ja bësh fejesës? — pyeti pasagjeri.

— Të thashë që qejfi s'ma ka të ngatërrohem me atë profesorin, po, edhe që t'ja prish qejfin djalit s'më bën zemra...

Gjatë rrugës, që zgjati tri orë e ca, shoferi s'e lëshoi muhabetin e fejesës nga goja. Ajo që po ndodhë i rëndonte shumë, e për ta lehtësuar brrën kishte nevojë të bisedonte, ndaj fliste me pasagjerin e tij të panjohur sikur ta kishte ndonjë të afërm.

Mbasi kishin heshtur një copë herë shoferi pyeti:

— Sa vajti sahati?

— Kaloi nga gjashta.

— Sa ore?

— Gjashtë e dhjetë.

— Ej dreq, ramë pas llafit e kemi ecur si breshka — tha shoferi dhe i ndërrroi marshin maqinës. — Më presin në shtatë.

— Po vajzën e njihni? — tha pasagjeri.

— Jo. Po ndonjë e përkëdhelur që rri tërë ditën në pasqyrë e s'i zë gjë dora do të jetë, vajzë profesori e... Po ç'të bësh, ky qe fati. Unë, që thua ti, vetëm në fotografi e kam parë. Kështu si kashtë s'është e keqe, jo... Ka ditur të zgjedhë qerratai... Ama edhe unë alamet djali kam!...

Shoferi futi dorën thellë në një kasetë metale like në të djathtë të timonit dhe nxori një letër të palosur, mbi të cilën dukeshin gjurma të gishtrinjve të tij. E shpalosi letrën duke e drejtuar timonin me bërryl dhe nxori që andej dy fotografi.

— Ja djali — dhe i zgjati pasagjerit fotografinë e të birit. Ai e vërejti një çast dhe i buzëqeshi shoferit.

Me të vërtetë që paskeni alamet djali. Ju ngjaka shumë.

— Nga sytë e nga buza e poshtme i ka ngjarë s'ëmës.

— Kështu duket djalë i gjallë, i shkathët.

— Ja dhe ajo — shoferi zgjati fotografinë tjetër.

— Ishte një fotografi e vogël dhe e errët. Tashmë maqina ecte shpejtë mbi një copë rrugë të paasfaltuar, e pasagjeri s'i kapte dot tiparet e vajzës. Shoferi e vuri re këtë dhe ngadalësoi shpejtësinë. Pasagjeri fërkoi syzat me mollëzat e gishtrinjve.

— Pa dale, dale.

Shoferi ngadalësoi akoma më shumë shpejtësinë. Pasagjeri sikur s'u besonte syve.

— Pa mbaje, mbaje një minutë!

Shoferi ndaloj maqinën. Pasagjeri mbërtheu

shikimin mbi fotografi e ra në mendime. Shoferi zgjati kokën e pa orën në dorën e pasagjerit.

— O, ho gjashtë e gjysmë. Zor se do të arrij në shtatë. Pastaj të thashë se ç'më porositi gruaja — dhe e nisi maqinën.

Pasagjeri i kapi dorën.

— Mbaje, mbaje — ai s'i hiqte sytë nga fotografia dhe buzëqeshte.

— Gjashtë e gjysmë ora, byrazer... në shtatë

— dhe ndërroi marshin.

— Çdo gjë mund ta merrja me mend, po që do ta fejoja vajzën kështu s'do ta besoja kurrë. Megjithatë është një gjé e bukur!

Shoferi shtangu. Pak më tej maqina ndali.

Ata u panë një çast në sy. Pastaj i zgjatën dorën njëri-tjetrit:

— Të na trashëgohen!

S H I

Retë u mblodhën çuditërisht shpejt nga të katër anët e horizontit. U dëgjua papritur një gjëmim i fortë, që drodhi xhamet e vitrinave e i hutoi disa plaka aqë shumë, sa harruan e bënë kryq në mes të rrugës. Pastaj, sikur të kish shpërthyer nga nëntoka, u lëshua një erë e fortë, që ngriti duman pluhurin e rrugës, i vuri mimozat në një valle të shpejtë dhe e lodhi një turist, i cili ndiqte kapelën prej kashte e s'e kapte dot se, sa zgjaste dorën, ajo kërcente njëzet metra më tej si një gjinkallë.

Pikat e para të shiut ranë pa u ndjerë, aq sa një pjesë e kalimtarëve u habitën e ndonjëri kur ndjeu lagështinë e pikës së parë kujtoi se mos ishte dhuratë e ndonjë zogu të pakulturuar. Retë i çau një shkrepitimë dredhake, e pas kësaj pikat e shiut u bënë më të dëndura. Ato ishin si kokrra lajthie dhe aty ku binin linin një njollë sa një monedhë pesëdhjetë qindarkëshe.

Nëpër rrugë u dukën grupe njerëzish, që vraponin në drejtime të ndryshme. Vetëm ata që ja dinë shiut të verës në qytetin tonë u turrën drejt strehëve më të afërtë.

Ja, nën strehën e vogël të një kinkalerie kanë zënë vend pesë kalimtarë.

— Bobo... Kam nxjerrë në diell jorganin e atllasit... Sikur të mos jetë kujtuar vjeħħra ta heqë... — i thoshte një grua shoqes së saj.

— Unë kam hallin e Fotaqit, moj motér... Ai punon në mes të fushës. Në mëngjez koha ishte lule, dhe ai s'mori as ċadrën, as ġizmet... Apo s'e ndjek ai i shkretē grip... Me tē shkuar t'i bēj ponçin gati. E di unë, sa tē vijë...

— Bjerë o bir, bjerë, se bereqet je-għeohej një plak e shkonte nēpér mend parcelat e hamulloreve, që kish parë një javë më parë, kur kishte shkuar në eskursion me pensionistēt e lagħej.

— Po nē Durrës bie vallé!? Hé!? Sikur tē mos hapet deri nē darkë na fiku! Dy tē diela pa shkuar nē plazh... E tmerrshme! — thoshte me vete i mērзitür një djalë i ri.

I pesti që qe futur pér t'u mbrojtur nën strehën e kinkalerisë ishte një djalë rreth tē njézet e pesave, veshur me një kostum teritali monopet. Ai nuk fliste, veċċ rrudhha bużet e shtyhej pas tē tjerëva, duke hedhur orę e ċast sytē mbi kēpucet e tij llustrafin.

— Kemi lajmëruar nē komunale që tē na ndërrojnë ċatinë e shtepisë, po akoma s'po vijnë — tha grua ja, që foli e para.

— S'éshtë nē terezi komunalja. Edhe rrugicen tonë s'po e asfalton akoma... Kushedi ċ'baltē do tē bēhet tani, — nxori zë më nē fund ai me kostum terital dhe hodhi përséri sytē mbi kēpucet e tij.

— Kushedi si do tē jetē bérë Fotaqi!

— Bjerë, o bir, bjerë!

— Këtë shi desh deti e tani për një javë s'vjen në terezi...

— Po mos jetë kujtuar vjehrра, iku jorgani i atllasit!

Aty nën strehë pesë boshte tirnin, gjithsecili fillin e vet. Tani shiu nuk binte me pika, por me litare të ujtë.

— Shikoni — tha dikush papritur.

Ata panë një njeri, që vraponte në shi. Të pestë ata që ishin nën strehë e ndiqnin me sy atë që vraponte dhe gjithsecili e tirte fillin e tij sipas boshtit të vet.

Ai që vraponte ndali përballë tyre, nja pesë-dhjetë metra larg, pranë një «shyte» me rimorkjo ngarkuar me thasë. Kërceu mbi maqinë dhe filloj të shpaloste një mushama të zezë. Sa mbulonte njërin cep të karrocerisë, turfullimi i erës jangrinte mushamanë në cepin tjetër. Atyre, që rrinë nën strehë, u kapi veshi një të sharë të rëndë të shoferit. Ai jepte e merrte, po era e sillte vërdallë, sikur donte të tallej me të. Një herë ja hodhi mushamanë në tokë.

Ata që ishin nën strehë u panë sy në sy. Secili tha diçka në gjuhën e heshtjes së tij.

— Hm... m — hunguroi plaku, duke fshiku lluar dy të rinjtë me një shikim qortues, dhe u nis drejt maqinës. Shpejtonte duke tërhequr zvarrë këmbën e majtë dhe dukej sikur pas çdo hapi do të rrëzohej. Pas tij u nis edhe ai që fliste për plazhin. Edhe dy gratë, e harruan jorganin e atllasit e Fotaqin dhe e lanë vetëm atë me këpucë illustrafin. Tani edhe filli i tij nisi të ngatërrrohet pas boshtit e të këputet. Bëri një gjysmë hapi nga

streha, por me të rënë pikat e para të shiut mbi këpucë, ai ndërroi mendim. Katër të tjerët po ndihmonin shoferin. Ai mbajti një çast shikimin mbi ta e ndjeu se një forcë e tërhoqi dhe vrapoi drejt tyre pa parë se ku shkelte.

Maqinën e mbuluan shpejt, por për rimorkjon e patën vështirë, se mushamaja ishte disa copash. Shoferit fytyra i lëshonte avull e nga flokët i rriddh-nin currila uji. Si rregulluan edhe copën e fundit të mushamasë mbi rimorkjo, ai u dha të gjithëve dorën e tij të madhe si putër ariu, të përlyer më baltë e me ndryshkun e telave, me të cilat kishte lidhur mushamanë.

— Po çkanë këta thasë, o bir? — e pyeti plaku.

— Sheqer... Sikur të mos e kishim mbuluar, pas ndonjë ore do të mbushej rruga me sherbeti — tha shoferi. Pastaj i shkeli syrin plakut:

— Do të bëhej i trashë si sherbet bakllavaje e juve do t'u ngjiteshin këmbët. Do të mbeteshit atje nën strehë.

Të gjithë qeshën. E, ndonëse litarët e ujtë s'po këputeshin akoma, ata mbetën një çast aty pranë maqinës. Buzëqeshja e shoferit ngrihej mbi ta si një çadër e madhe, poshtë së cilës nuk e ndjenin stuhinë e natyrës dhe shiun e shqetësimeve të vogla, që i lagte pak më parë aty nën strehën e kinkalerisë.

Tani ata ishin gjashtë boshte, që tirnin të njëjtin fill. Mushamaja e zezë mbi thasët e maqinës u dukej si një mbulesë e madhe, nën të cilën mbrohej nga shiu edhe jorgani i atllasit, edhe Fotaqi, edhe plazhi, edhe këpucët ilustrafin...

«SHKRIMTARI»

Minatorët hynin njëri pas tjetrit, lëshonin nga një «mirëmbërema» të fortë sa po kalonin prakun, merrnin pjatat e gjellës në sportel e uleshin pas tryezës. Salla e mencës pothuajse ishte mbushur plot. Minatorët siç duket dikë pritnin, se herë pas here ja lëshonin sytë derës.

— Erdhi! — u dëgjua papritur një zë nga tryezat e para. Të gjithë kthyen kokën.

I porsaardhuri ishte hijerëndë. Vetullat e ngrysura i dukeshin shumë të trasha. Ndryshe nga të tjerët ai nuk e lëshoi atë «mirëmbërema» të fortë, karakteristikë e minatorëve. Mori pjatat e gjellës dhe qëndroi një çast në krye të sallës. Me sa duket kërkonte një tryezë bosh, por meqë nuk gjeti zuri vend në një tryezë aty pranë, ku ishin ulur dhe dy minatorë të tjerë. Hante pa i ngritur sytë nga pjata. Mbi të binin breshëri shikimesh nga të gjitha anët. Një çast u dëgjuan vetëm trokitjet e lugëve mbi pjata.

— Mua më dhëmbin sytë kur e shoh, — këto fjalë të minatorit plak i ngjanin raketës së kuqe apo fërshëllimës së një bilbili, që lajmëron fillimin e sulmit.

— Kupa u mbush e po na derdhet në duar,
— e pasoi dikush plakun.

Pastaj fjalët filluan të dëgjoheshin nga të gjitha tryezat.

Ai vazhdonte të hante. Tek përtypej, muskujt e nofullave nën mollëza i fryheshin nga nervozizmi. Hante duke përtypur shqetësimin e tij në heshtje. Heshtëte dhe një tjetër, që kishte zënë vend në fund të sallës e shkruante papushim në një bllok të kuq. Gjithë të tjerët flitnin. Dëgjohej sidomos zëri i atij minatorit plak, zëri i Kuqos, një minatori tjetër rrreth të tridhjetave, që e kishte fytyrën me pika të kuqe dhe zëri si jehonë shpelle i një vigani, të cilin shokët e thërritnin «Harushë».

— Drejtoria duhet të shkundet, duhet të marrë masa...

— Po e zvarriti akoma, do ta shkundim ne edhe drejtorinë.

— Maskarai!...

Vetulltrashit i mbeti luga në dorë.

— Më ngadalë or ti mik, se fundja shoku ynë është... Vërtet gaboi, po...

— C'gaboi more, ai na nxiu faqen të gjithëve.

— S'jemi mësuar me të tilla gjëra ne...

— E kemi shok...

— Shok të parë kemi punën, pastaj të tjerët.

I heshturi, që rrinte në fund të sallës, shkruante papushim. Mbi fytyrë i qe endur një buzëqeshje kënaqësie.

— Nesër të mblidhet kolektivi e t'i japim fund.

— Të mos e shohim më këtu.

— Na dhëmbin sytë — tha përsëri minatori plak.

— Pse të mblidhemi nesër? Ja ku jemi të gjithë.

— Duhet të jenë edhe shokët e drejtorisë.

— Mund të vendosim dhe vetë.

— Gjyqi revolucionar s'do shumë burokracira.

— Për maskarenjtë...

Vetulltrashi s'u përmblajt.

— Mbyll gojën, dëgjove?

— Unë thashë të vërtetën, ti na fëlliqe, si s'të skuqet faqja.

— Mbyll gojën, të thashë. — Vetulltrashi u ngrit i revoltuar. Edhe atij që i foli, damari në të djathtë të ballit i rrihte si çekan. Shikimet e tyre u përplasën.

— Ej, ndajini — thirri kuqua dhe brofi në këmbë.

— Të lutem mos... lërini — i tha ai që po shkruante, i cili ishte үlur dy tryeza më tej.

Kuqua ktheu kokën i habitur. Edhe të tjerët. kthyen kokën.

— Ndajini — thirri përsëri Kuqua.

Ai që shkruante foli përsëri, por s'e dëgjoi askush. Ata i ndanë. Vetulltrashi u ul përsëri rië vendin e tij.

— Ç'më bëre, mor shok! — i tha Kuqos ai që shkruante.

— Të mos i kishe ndarë më mirë.

— Po si thua ti... T'i linim të rrightheshin?

— Ç'je ti o shok?.. se ramë pas atij e të harruam fare — pyeti Harusha.

— Shkrimtar — tha ai që shkruante.

— Demek paske ardhur të lidhesh me bazën.
«Shkrimtari» pohoi me kokë.

— E përse i mbajte tërë ato shënime? — e
pyeti Kuqua.

«Shkrimtari» buzëqeshi.

— Do të shkruaj një dramë për këtë që ju
ka ndodhur me atë shokun. Është një temë inte-
resante.

— Edhe kjo na duhej... Ta marrë vesh gjithë
Shqipëria — tha me keqardhje plaku. Pastaj iu
kthye vetulltrashit:

— E, ore, dëgjon ti apo jo?

Ai s'foli.

— Ra pulsi — tha i pakënaqur «shkrimtari»
dhe lëshoi stilografin mbi blok.

— Ç'thotë, ç'thotë ai miku? — pyeti dikush.

Ata që e dëgjuan ngritën supet.

— Ç'është e vërteta unë e di të gjithë ngja-
rjen. E di që ai shkoi i dehur për të bërë zbra-
zjen e minave dhe mënt vrau shokët, e di që nuk
sillet mirë me gruan, që shikon vetëm interesin
e tij... I di të gjitha, po erdha këtu që ta shoh
procesin të gjallë, ta shoh me sytë e mi si zhvi-
llohet ngjarja... Dua ta ndjek atë deri në fund...
Ju më dëmtuat shumë që i ndatë ata..., — po i
shpjegonte «shkrimtari» Kuqos, i cili i dukej pak
më i ngritur se të tjerët. — Tani linja mund të
marrë një rrugë tjetër. Kurse drejtimi që pat
nisur ishte shumë interesant, më kuptioni?

— E di si thua ti, shoku shkrimtar? — e
mori fjalën Kuqua që me sa duket qe mërzitur
nga shpjegimet e tij.

Bisedën e tyre e ndërpree një zë i çjerrë.

— Ej, ku shkon? Do japësh llogari njëherë.

Vetulltrashi ishte ngritur nga tryeza e po bënte nga dera. Zëri i çjerrë dhe shikimet e të tjerëve e gozhduan. «Shkrimtari,» rrëmbeu stilografin dhe afroi blokun.

— Më duket se linja po kthehet përsëri në rrugë — tha i kënaqur e filloj të shkruajë.

Përsëri nervat e sallës u ngritën. Vetulltrashi bëri përsëri përpara, por derën ja zuri trupi i madh i Harushës. Ai qëndroi dy hapa larg tij.

— Kthehu andej dhe thuaj përse u katandise në këtë gjëndje, — i tha Harusha i qetë dhe i tregoi sallën.

— Liromë rrugën — tha vetulltrashi.

«Shkrimtari» s'e fshihte dot kënaqësinë, u ngrit e doli në krye të sallës për ta zotëruar më mirë gjendjen.

— Liromë rrugën, të them, — vetulltrashi bëri dhe një hap përpara. Harusha dukej çuditërisht i qetë. Përsëri filluan të flasin të gjithë.

— Pse u katandise kështu?

— Kemi ngrënë bukë kaq vjet bashkë, na e hap zemrën...

— Dëgjon ti apo jo? Po presim fjalën tënde.

— Liromë rrugën. — Kësaj here zëri i tij të shponte veshët, ishte kërcënues. «Shkrimtarit» i shkëlqenin sytë.

— Harushë, hapja derën — tha minatori plak.

— Ne nxjerrim vagonat plot nga galeria e jo mos ja nxjerrim fjalët këtij. Në mos sot, nesër...

— foli një tjetër.

— Lëre të shkojë, — mbasse ka nevojë të mendohet — u dëgjua zëri i Kuqos.

Harusha u hoq mënjanë pa qejf.

— Ah, po pse.? — psherëtiu «shkrimtari». Pastaj iu drejtua Kuqos:

— Ishte moment shumë interesant... Përsëri ma nxorët veprimin nga linja... Ç'bëtë!

— Këtu nuk është theatër, o shok — i tha Kuqua.

«Shkrimtari» mbylli stilografin i mërzitur:

— Po ju e dini që drama do aksion, do veprim, puls... Ja, sikur ata të ishin përleshur...

— Ç'thua, more! — ja preu një minator.

— Ngjarjet do të kishin marrë një rrugë më të mirë.

— Si ore më të mirë!? Ç'flet ti?!

— Unë e kam fjalën për dramën, do të ishte diçka e bukur.

— Dëgjo o mik, ne këtu nxjerrim qymyr e s'bëjmë drama de, — tha Kuqua.

— Po ja, këto ngjarje, që ndodhin midis jush, janë interesante, dramatike.

— Ne duam të mos ndodhë kurrë kështu.

— Po ne dramaturgët ç'do të bëjmë?

— Hajdeni këtu tek ne, miniera do krahë pune.

— Si «shkrimtar» që je, duhet të na jepje një mëndje o shok, kurse ti dashke të na bëke asoj, ç'i thonë more... për thjatro...

— Nejse, sidoqoftë ngjarja është interesante, mund të dalë dicka e bukur — tha «shkrimtari» duke mbyllur blokun dhe u nis të dalë. Kuqua ja pat:

— Edhe ti na dhe një temë të bukur për estradën tonë, o shoku «shkrimtar»!

KAPISTALLI

Ai ndjeu zilen e sahatit në dhomën e poshtme, pastaj hapa mbi dërrasat e vjetra të dyshemesë dhe krakavitjen e lehtë të hapjes së një kanate dollapi.

— U ngrit Vasfiu t'i japë ilaçin djalit.. Vajtk mezi i natës — tha me vete dhe u kthyen në krahun tjetër.

Era, që sillnin grykat nga veriu i fshatit, vazhdonte parreshtur atë këngë të ftohtë, me ca fish-këllima të zgjatura, që shuheshin nëpër hatullat e shtëpisë. Ishte një natë e ftohtë janari, natë cikme.

Por rrebeli që ja vodhi gjumin atë natë Vesel Grezit nuk ishin fshikujt e erës, që ja rrifnin shtëpinë nga të katër anët, e as të ftohit e palcës së dimrit...

Ai ishte argasur me këto gjëra...

— E kokë, o kokë... do shtypur ti...

Ndërroi dhe një herë krahun, por më kot.

Ju bë sikur dëgjoi një të pëllitur kau, nga larg, që era e dridhte dhe e shpërndante si jehonë. Ju duk sikur balashi i erdhë aty, në mes të dhomës.

I shfaqej balashi, kur ishte akoma viç i vogël, duke u hedhur nëpër oborr me bisht përpjetë, pastaj duke gërmuar ledhet e hendeqeve me brirë, iu kujtua hoxha i fshatit, që i tha t'i bënte demit një hajmali, se ndonjë ditë do të pëlciste në prak të portës nga syri i keq.

Po ajo vjeshtë kur u vunë për herë të parë në zgjedhë! Katër burra nuk e bënин dot zap. Veseli kishte zgjedhur tokën më të fortë, një jonthishte për të çarë, që ta shtronte balashin. Por edhe tanj atij i dilte përpara si në pasqyrë se ç'kishte hequr atë ditë... Kau i ri merrte vrull e sulmonte përpara, kurse kau plak i krahut tjetër, që ishte bërë djersë e shkumë zvarritej mbi ugar. Veseli mezi mbante plugun. Ishte hera e parë që ai duke ecur pas qeve, thuajse me vrap, pengohej mbi plisat e binte.

E çfarë s'iу kujtua Veselit... Por kujtimet vinin deri në mëngjezin e kësaj dite dhe ato këputeshin si me sopatë nga ajo pëllitje — jehonë, që i ushtonte në veshët dhe i hynte thellë nëpër trup.

— E kokë, o kokë... do shtypur ti... — tha përsëri.

— Kjo i ka fajet, kjo e hapi gojën... po unë pse mora mëndtë e saj — mërmëriti pastaj me vete dhe i hodhi një shikim të rreptë nëpër errësirë së shoqes, që flinte e qetë pak më tej duke gërhitur lehtë.

Atë ditë Veseli kishte dorëzuar pendën e qeve në kooperativë, që sa po ishte krijuar në fshatin e tyre, aty midis dy maleve. Atë se ç'e kishte gërvishtrur përbrenda, kur kafshët kishin kaluar prakun e shtëpisë. Por tani në mesnatë ai nuk e ndjente dhimbjen e kësaj të gërvishture. E mundonte diçka tjetër.

Kur i kishte nxjerrë qetë në oborr, e shoqja i kishte thënë:

— Vesel, hiqja kapistallin Balashit, gjynah, pse të na shkojë kot. E ka të ri fare, hiqja t'ja vemë lopës.

— Ç'thuaj moj? — i qe përgjigjur aty për aty Veseli, por, pa e kuptuar as vetë i qe ndërruar mendja.

— Mirë t'ja heqim kapistallin, po çfarë t'i vemë Balashit?... Ai kapistalli i vjetër i lopës nuk i bën, e ka kokën të madhe ky birko...

— Gjejmë ndonjë copë litar... — i pat thënë e shoqja dhe qe futur në një të ndarë të shtëpisë, ku mbanin veglat bujqësore.

— Hë moj, ç'u bëre... në Stamboll shkove tablesh a?...

Meremja s'u përgjegj... Veselin s'e mbante vendi.

— Hë moj de, ku humbe të shkretën, Mereme... e — Kësaj here zëri i tij ishte gjithë inat.

Më në fund Meremja u duk në oborr me ndonjë gjysmë pasi litar në duar.

Veseli i zgjati asaj kapistallin, që ja kishte hequr kaut dhe i rrëmbeu litarin nga duart. Provoi t'ja lidhte kaut në qafë, por nuk arrinte të mbësh-

tillej as edhe një herë. Provoi t'ja vinte në brirët. Mbasi e shkoi përqark tyre, mbi pullën e bardhë të Balashit u var vetëm një copë nja dy pëllëmbë litar.

— Ama ç'më ke sjellë dhe ti... Me këtë ta lidh, që lidhsh... pse dhi është ky... — i shfryu së shoqes.

Ajo ngriti supet.

— S'gjeta tjetër.

Veseli e hoqi litarin nga brirët e kaut dhe e flaku tutje...

— Ajs Balash... Kazil... Ajs... — dhe doli së bashku me qetë...

Gjatë ditës ai sikur e harroi punën e kapistallit, por sa vuri kokën në jastëk i shkoi mëndja atje dhe kishte disa orë që po hahej me vete.

«Ti e ke fajin moj, ti... ti u bëre sebep» — i thoshte nganjëherë me mënd së shoqes, që vazhdonte të flinte e qetë.

«Po unë si shkela në dërrasë të kalbur? Më duket se kanë filluar të më lënë mëndtë tanë në pleqëri. I gjori Balash... kushedi, do ta kenë lidhur me ndonjë copë litar për qafe... po sikur të këputet ndonjë kanatë e ta godasë? Mos mbytet... Po sikur ta kenë lidhur me tel për briresh!» — dhe nxirrte një pshëretimë të thellë nga fundi i kraharorit.

Fshatarin nganjëherë e lidhin me bagëtinë, që ka rritur vetë, ca fije të holla ndjenjash, që përgjasojnë shumë me ato të dashurisë për djalin a për vajzën.

Tashmë era kishte pushuar e nëpër atë qetësi, që e griste vetëm lehja e ndonjë qeni, Veseli, të pëlliturat e kaut, i dëgjonte edhe më quartë.

— Hej bela... Kësaj i thonë jep kalin e mbaj potkoin... Po pse ore, me zor të futën në kooperativë?!

E pa veten në mbledhjen e fshatit, kur u ngrit një ndër të parët dhe dha fjalën për të hyrë në kooperativë... I doli parasysh dhe ajo lista e gjatë, e aty, në rrjeshtin e tretë dalloi firmën e tij, një shkaravinë, që e hodhi me aqë zor...

— Jo, jo, vetë e dhashë fjalën unë, vetë e firmosa... Apo mos e bëra këtë që të dukeshë mbi të tjerët!?

Tani i kujtohej ajo mbrëmje, kur u kthye nga mbledhja, se si ja shtroi me ralki me të bijtë dhe ngriti shëndete për kooperativën.

— Jo or jo, vetë hyra e mirë bëra që hyra... S'jam hiç pishman. Po kësaj ç'i thonë, që shpura kaun e mbajta kapistallin... Ku i pata mendtë... Ç'do të thonë të tjerët? Le që ata s'dinë se me se i lidhja unë qetë në ahur. Po unë pse ta bëja këtë... Kushedi si e kanë lidhur Balashin... He, moj pikë e zezë...

Veseli bluante e bluante në kokë e mendimet përziheshin e ndërthureshin si purtekat në gardh.

Nganjëherë mundohej ta bindte veten se s'u bë kjameti që e shpuri kaun pa kapistall... Kishte edhe më keq! Demiri ca kohë më parë e kishte shitur njërin ka, gjoja se e kishte të sëmurë e mos i ngordhë... dhe i kishte futur 3.000 lekët në xhep.

— Ama mëndje, po pse ore, me Demirin e Syrjaut e vë veten ti, që është djalli i fshatit!? C'pret nga i nipi i Zenun Beut, që kishte pesëqind

kile farë në kohën e agallëkut... Të tjerët shiko, që ja falën kooperativës me qe, me kuaj, me mushka, me lopë e me dhi, që i kishin tepër, se Demiri një është në fshat.

Sytë filluan t'i djegin përbrenda, ndërsa kapakët i rëndonin. Edhe trupin e ndjente të lodhur.

Njëherë e zuri gjumi, por shpejt kapakët e rënduar u hapën dhe atij iu duk sikur po shihte aty në errësirë lopën e tij pullalije, që i gëzohej kapistallit të ri dhe Balashin, të mvrenjtur dhe të egërsuar si atë ditë kur e futi për herë të parë në zgjedhë.

U mat të ngrihej nga rrrobat, t'i hiqte lopës kapistallin e të shkonte t'ja vinte Balashit, por u kujtua që stalla në atë kohë ishte e mbyllur.

Psherëtiu dhe u shtri përsëri.

U suall disa herë nëpër dyshek dhe më në fund e zuri një gjumë i rëndë.

Por edhe pse flinte, atij i ishte fiksuar aty para syve kapistalli i Balashit. Nëpërmjet hundëzës së tij ai shikonte të kaluarën, kur i dhanë tapinë e tokës, kur lëronte e mbillte, kur futi Balashin në zgjedhë... dhe kujtimet hynin e dilin lirisht në atë unazë prej lëkure të trashë, ishin aq të afërtë me atë kapistall, kishin diçka të madhe të përbashkët.

Por nëpërmjet hundëzës filloj të rrjedhë e ardhmja, në fillim aty kaluan dyzet qetë e kooperativës, pastaj brigadat e fshatarëve që shpërndanë heshin në drejtime të ndryshme, pastaj... vërsuan stivat e thasëve me grurë e tufa e madhe e dhive, karvani i gjatë i kuajve dhe mushkave që transportonin patate... Rryma e begatisë, e

lumturisë, që vërshonte ishte çuditërisht e madhe e nuk kalonte dot nëpër atë rrëth të ngushtë të hundëzës.

Veselit iu duk sikur nëpër të u fut një traktor i madh, por nuk dilte dot mëtanë... Traktoristi luajti një marsh dhe buzëqeshi, traktori çau përtetj, hundëza u këput...

— Mos... — thirri në gjumië Veseli dhe instinktivisht shtriu duart përpara. Kur hapi sytë, pa se dita kishte zbardhur fare. Ndonëse kishte bërë e s'kishte bërë dy orë gjumië, veten e ndjente të lehtë.

Fërkoi nga dy herë sytë, u vesh dhe doli nga dhoma. Në oborr i hodhi fytyrës një grusht ujë nga kova, që qëndronte pranë pusit, u fshi me shaminë e xhepit dhe shkoi në ahur.

Meremen e gjeti duke mjelë lopën.

— Ç'ishte ky gjumië që të kishte zënë mor burrë? Ti ngriheshe pa zbardhur dita? — e pyeti ajo, më të ndjerë hapat.

Ai s'iу përgjigj fare. Futi dorën në një vrimë midis dy trarëve e, kur pa se nuk gjeti gjë, i foli vranët së shoqes:

— Ku e ke futur atë dreq kapistalli të lopës? Këtu e kisha lënë.

— Ç't'u kujtua kapistalli që me të hapur sytë... Aty e ke, mbi dërrasën e derës.

Ai e mori dhe iu afrua lopës. I hoqi kapistallin e kaut dhe i vuri të vetin.

— Vërtet mirë u kujtove, i rri si i madh ky i Balashit, do ngushtuar ca... Po lëre më mirë tanj e bëje kur të kthehet nga puna — i tha e shoqja.

Ai përsëri nuk iu përgjigj.

— Ku ma ke lënë torbën e bukës? — e pyeti.
Aty mbi çikrik e ke.

Veseli doli nga ahuri; mbas tij dhe Meremja, e cila mbaroi së mjeli lopën. Ajo e kuptoi tani se i shoqi diç kishte.

— Po kapistallin ku do e shpiesh? — e pyeti me gjysmë zëri, kur ai hodhi trastën në sup e bëri të dalë.

— Do ta shpie atje ku e ka vendin, atje ku duhet ta kisha shpënë dje... po mora mëndtë e tua dhe unë budallai — ja ktheu me të ashpër Veseli pa kthyer kokën nga ajo dhe doli nga shtëpia...

FEJTONI

— Alo! Shoku Klostandin?.. Po, unë jam, unë... E di si éshtë puna?.. Dua të shkruaj diçka pér ndonjë që... Alo! Më dëgjon?.. E, desha të shkruaj diçka, them, pér ndonjë që me fjalë éshtë kundër ideologjisë e zakoneve fetare, kurse në të vërtetë... Hë, mirë e the, i ke rënë pikës, pér një mësallë me dy faqe...

Ke ndonjë atje në bllokun tënd ti?.. Jo? Asnjë, asnji?.. Ashtu, hë? Të gjithë e paskan kuptuar drejt domethënë... Mirë, o shoku Kosta, mi-rë... Kur s'ka, s'ka. Mirë u pafshim!

Lashë receptorin i mërzitur. Ishte i katërti kryetar fronti që po merrja. Njërin s'e gjeta, tre të tjerët më thanë se në blloqet e tyre s'ka nga ata që kërkoja unë.

Isha në hall të madh.

— Shiko, kujdesu një çikë pér atë fejtonin... Të dalë diçka e goditur — më tha përsëri shefi.

I mërzitur që s'po e gjeja dot akoma «heroin» u ula në karrigén time. Mbi tryezë kisha një tufë letra, që i kishin dërguar dëgjonjësit pér një anketë, të cilën e kishim hapur ato ditë dhe që kishte po atë temë. «Si po luftoni ju kundër paragjykimeve e besimeve të kota fetare».

Fillova të hapja zarfet. Në njërin prej tyre gjeta një letër që më çuditi:

«I dashur vëllai im Vangjel!

Unë me tërë ç'kam në shtëpi jam fare mirë.
Dhëntë zoti që edhe ti me ata të tutë të jesh mirë.

Ti e di që unë s'para i kam qejf letrat, pran-daj s'po të shkruaj gjatë.

E di si është puna, Vangjel vëllai?! E premë fjalën për Aspasinë, po fejesën s'e kemi hapur akoma. Asaj sikur ja kish qejfi, por i thashë sus! S'e bëj unë ashtu partizanë fare, siç e bëri Koli i Tirkës e Maqua i Apostolit.

E siç të thashë fjalën e premë, po për ta mbaruar fare, ashtu zyrtarisht, e lashë për më vonë. E di kur?! Për natën e Shën Kozmait. Thuaj që s'më pjell kjo e shkretë mëndje! Demek me sebepin e dasmës festoj edhe emrin tim, gëzojmë edhe Shën Kozmain, i paçim uratën... Është ndryshe kur e bën fejesën në një ditë të shënuar... i ecën mbarëjeta çiftit. Unë jam fejuar ditën e Shën Thanasit, e gjer më sot e mbara më ka ndje-kur...

Këtë radhë do ta bëj të madhe, o Vangjo. Për Krisht po, kam ndër mënd ta djeg fare. Unë them që të mos mblidhemi në shtëpinë tonë, që mos biem në sy të atyre të lagjes. Se po na morën vesh ata, na e skuqin pastaj me ndonjë fletë-rrufe të mirë... Si thua ti?.. Sikur të mblidheshim andej nga Sofia? Ajo e ka shtëpinë si më të futur e komshitë i ka muslimanë, kështu që do tu pjekim mishin pa e përzhitur hellin.

Vangjo... ty po të vë një detyrë, të kam lënë

të zgjedhësh rakinë e mishin... Shiko mos navasësh andej ndo njëzet litra nga ajo e bekuara e Përmetit... mundohu mos gjeç ndonjë raki plakë, që kur ta tundësh të nxjerrë rruazat si flluska sapuni... Le që ti je merakli vetë... Mos harro edhe ndonjë sheleg të majmë, se xheku të zë dora ty...

E shiko, bëj si të bësh andej e shkëputu ca ditë më parë... Se mos të shpëton goja, a derëzi, e thua që do vish për Shën Kozma, se na djallose, na more më qafë...

Hajd, mirë u pafshim Vangjo! Mos harro q'të thashë për atë të bekuarën e Përmetit e të na vish me të tërë të shtëpisë.

Të qafoj me mall
YT vëlla.

Dëgjo ore Vangjo, se më doli nga mëndja. Ikonën mos e mbaj më aty ku e kishe se do vijnë të ta gjejnë e do të të bëjnë për pesë para. Po hap sytë se mos bën gabim dhe e heq fare. Bëje ashtu si e bëra unë. Vëri përsipër ndonjë pasqyrë të madhe, e anët mbuloi me një copë basmë...

Të vish me të gjithë, dëgjove, se pastaj s'i kemi mirë punët bashkë, për Krisht!»

Kjo letër, e cila kishtë ardhur gabimisht në redaksi, sikur ma freskoi humorin. Për një çast e harrova fare fejtonin, por shpejt më qeshi buza e m'u duk sikur pikërisht në letër unë kisha gjetur fillin e tij.

Bëra shaka me shokët se unë kisha bashkë-puntorin më të sinqertë të redaksisë. Por sido-

qoftë më duhej akoma punë. Nuk dija mbiemrin e bashkëpunëtorit» tim, adresën e tij. Ai në letër s'kishte shkruar as emrin, po këtë ma tregoi Shën Kozmai.

Sidoqoftë një farë materiali e kisha në dorë. Kjo më qetësoi. Atë ditë dhe të nesërmen u mora me një punë tjetër, duke menduar se tashmë për fejtonin s'më duheshin më shumë se nja dy orë punë.

Të pasnesërmen në mëngjez korrieri më solli një letër rekomande. Mbi zarf adresë e dërguesit nuk ishte. Vërejta shkrimin e adresës së redaksisë, por ai m'u duk fare i panjohur. E hapa zarfin me padurim. Në krye të letrës lexova: Përgjigje anketës suaj. E futa përsëri në zarf dhe e lashë mbi letrat e tjera që kishin ardhur për anketën.

— Po mirë, pse e ka çuar rekomande? Mos ka ndonjë gjë të veçantë — mendova pas pak dhe e mora përsëri letrën. Fillova ta lexoj:

Çështja që shtrohet në anketën tuaj është mjaft e rëndësishme. Edhe unë i kam përkrahur me gjithë shpirt iniciativat e mrekullueshme revolucionare që kanë shpërthyer në vendin tonë për shkuljen nga rrënjet të ideologjisë fetare. Edhe unë, të dashur shokë, e kam hequr ikonën. Feja na ka gënjer e na ka mashtruar tërë jetën, por tani s'na gënjen dot më. Shën Vasilit, Shën Thanasit, Shën Kozmait e vëllezërve të tyre u ka ikur koha... Ata s'na vënë dot më në gjumi me hashashin e tyre.

— E zakonshme — thashë me vete, por megjithatë i hodha një sy kalimthi edhe pjesës tjetër të letrës, e cila ishte nja dy faqe e gjysmë.

Autorit tē saj i priste shpata nga tē dy anët kundër fesë. Ai kishte marë edhe disa citate nga një kryeartikull i «Zërit tē Popullit».

Më têrroqi vëmendjen një shënim me laps kopiativ që ishte shkruar poshtë emrit tē letërdërguesit, Kozma Llagëmi.

Këtë letër vëllai im, Kozmai, gabimisht ma kishte dërguar mua. Kushedi, kur ka shkuar në postë i jam kujtuar unë e ka shkruar mbi zarfë adresën time. Për ato që shkruan Kozmai në letër edhe unë jam në një mëndje me tē.

Me respekt:
Vangjel Llagëmi.

Diç m'u kujtua. Nxora nga sirtari letrën që kisha lexuar para dy ditësh dhe i vura tē dyja pranë njëra-tjetrës. Ishte i njëjti shkrim, pra i njëjti Kozma. Ai i kishte shkruar letrat në një kohë dhe kur i ka postuar ka ngatëruar zarfat, pa e kuptuar se po bëhej «korespondent vullnetar» i emisionit tonë.

Mora letrat dhe dola nga zyra. Tani fejtonin e kisha gati. Atij i mungonte vetëm titulli e duhej shtypur në maqinë.

— Shkruaj — i thashë daktilografistes. Në krye të faqes.

Po e vazhdojmë emisionin tonë me fejtonin autokritik:

«Mësalla me dy faqe»

Nga Kozma Llagëmi.

Kryerreshjt:

ARMIKU I KLASËS

Ja fotografia e tij! Ti e njeh atë. Ngre super!? Nuk të kujtohet?! Shikoje, shikoje me kujdes e ai do të zgjohet në kujtesën tënde. Mirë pra, unë po të ndihmoj.

Të kujtohet kur udhëtoje me autobus «Skoda» për në qytetin tënd? Të kishte qëlluar biletat Nr. 17 e ti ishe ulur në një nga ndenjëset portative në mes të autobusit. Kur automjeti po ngjiste Qafën e Thanës, ti ndjeve trazime në stomak, të zuri maqina. Bashkudhëtari që të rrinte në krah të tha:

— Kaloni në vendin tim... Këtu pranë dritares do ta kini më lehtë...

— S'ka gjë, do të më kalojë — i the ti.

— Ju lutem, e kam për detyrë... Urdhëroni...

Ai të liroi vendin dhe ti e falenderove gjithë respekt.

A e kujton tani? Jo!? Mbase ke të drejtë. Ty gjithnjë të ze maqina, sigurisht edhe të tjerë të kanë liruar vendin pranë dritares.

Po atë muzg korriku, kur ti po rrije në bregdet e po vështroje si shuhej dielli atje ku ujrat e mjegullat shkriheshin, a e mban mend?

Dikush të erdhi aty pranë e të ftoi të luaje me top. Dhe ti s'ja prishe qejfin.

Ai bënte pritje të mrekullueshme, ti qeshje dhe e harrove diellin fare.

E, a e njeh tani? S'përgjigjesh?! Dhe përsëri ti ndoshta ke të drejtë. Ku mbahen mend të njo-hurit e plazhit.

Ti me atë je njobur edhe në një ekskursion. Po, po, je njobur, kujtohu! S'e mban mend si të bëri pér vete me anekdotat që s'kishin të mbaruar e si ti mbaje ijet me duar se të dhimbnin nga të qeshurit?! Po tani? Përsëri ngre supet?!

Ndoshta ke shkuar shpesh në ekskursione dhe ke njobur shumë shakaxhinj.

Mirë pra, tani sill ndërmend kur ke shkuar në kinema pér të parë filmin: «Për një gotë brrë». Ai ishte në krahun tënd e të përkthente fjalët e personazheve apo ata i nxirrnin nga goja. Të numronte filmat në të cilët kishte luajtur njëri apo tjetri artist.

Ishë ky që sheh në këtë fotografi. Ja, shikoje dhe një herë... Përsëri jo!?. Sidoqoftë në këtë rast mund të kesh më shumë të drejtë të mos e njobësh. Ti e pe vetëm një herë para se të fillonte filmi, pastaj u bë errësirë e kështu që s'ja mban dot mend fytyrën.

Kurse tani do ta kesh shumë të lehtë. Ky që sheh në këtë fotografi të ka ardhur edhe në shtëpi. Mos u habit. Ti i ke dhënë cigare me dorën tênde. I ke dhënë edhe kafe. «Është e pamundur!» Ja ku të themi unë që ai të ka ardhur në shtëpi, të ka ardhur kur të vdiq babai, pér ngushëllim.

Çudi! As kjo s'të kujtohet? Le që atë ditë ti

ke qenë i turbullt, pastaj hynë e dolën shumë e s'i mban mënd fytyrat e të gjithëve.

Ti me atë je njojur edhe në radhë, duke pritur që të shkarkohej maqina e të merrje shalqin, edhe në stadium, edhe në park duke shëtitur me djalin tënd të vogël, edhe...

Ndoshta kujtesa jote vizive është e dobët... Mundet. Mund të ketë edhe kjo arësyet e veta: ai është njeri fare, fare i zakonshëm. Mbante një xhaketë kadifeje, pak të rjepur në bërrylet, një palë pantallona doku, këpucë të thjeshta, nga më të, lirat... Edhe në trup ai s'kishte asgjë të vencantë që t'i linte mbresa syrit tënd... Edhe në fytërë po ashtu, me përjashtim të një shënje në cepin e majtë të ballit, për të cilën ai si shumë të tjerëve edhe ty të ka thënë se e ka shënjën e një plage që mori kur ishte partizan.

Edhe duart i ka me kallo si të tuat. Një njeri fare, fare i zakonshëm për syrin tënd.

Megjithatë ti e njeh. Tani po i drejtohem kujtesës tënde mendore. Ke për t'u kujtuar menjëherë.

Në autobus, mbasi u qetësove nga trazimet e stomakut e mbasi të dha një kokërr mollë, fillojë të bisedojë përzemërsisht me ty. Por kur mori vosh se ti ishe agronom, të kujtohet ç'të tha? «ANDEJ agronomi është... ANDEJ... vilë, motocikletë... fermë personale...»

— Të kujtohet?

«Po». Unë ja preva shkurt e ai s'u ndie më».

Në plazh, mbasi mbaruat së luajturi me top, ai të priti para kabinës derisa u veshe dhe pastaj të futi krahun e të çoi tek lokali ku kërcenin turistët e huaj.

«Ky éshtë kërcim, kurse ne... tango labçë...
Kamë lexuar diku se Nju Jorku ka 5.000 kabare...
Londra... Tokio... Atje...»

S'e besoj t'i kesh harruar këto fjalë!

«Jo. Unë s'e lashë të vazhdonte më tej... E
fshikullova me shikim dhe i ktheva shpinën».

Në ekskursion, kur ty akoma s'të qe shuar e qeshura e anekdotave, ai ashtu si fare padashur ndezi radion e dorës. Ato fjalë që dëgjove, si një tufan i menjëhershëm, ta ngrinë gazin në buzë. «Komunistët po djegin kishat e xhamitë, priftërinjtë e hoxhallarët i nxjerrin dhe u rruajnë mjekrat në mes të bulevardit... Ata po shkatërrojnë familjet. I ndajnë vajzat nga të fejuarit dhe i martojnë më forcë, ose siç thonë ata, me dashuri.

Këtë zë...

«Unë u mundova ta mbytja: Ja rëmbeva radion dhe desha ta përplas mbas shkëmbit. Ai...»

Kurse në kinema mbasi të kishte bërë përvete me horizontin e tij të gjerë në fushën e kinematografisë, kur në ekran u duk një tavernë me këngëtarë gjysmë lakuriqe, me muzikë që... ai psherëtiu: Ç'jetë! Kurse rinia jonë... Eh, perëndimi..!

Salla e mbyti zërin e tij me ilaritetin e saj të papërmبajtur. Atë e dëgjove vetëm ti, ai të foli pranë veshit, të ra edhe me bërryl...

«Unë e shava rëndë. Ndoshta dhe bërtita, se pse disa kthyen kokën dhe më panë vrëjtur. Kur mbaroi filmi, vendi i tij ishte bosh».

Edhe kur të erdhi në shtëpi për ngushëllim të rrëmbeu shpejt me dhimsurinë e tij kur i dhe kafen: «Të rroni vetë! S'ke ç'i bën, jeta kështu e

ka... Ama burrë për kokën e burrit ka qenë!..»

Por kur lëshoi filxhanin mbi tabaka e si ktheve ti shpinën, ai u tha të tjerëve:

«I ra damllaja të shkretit plak, se i biri u fut në kooperativë. E dinte plaku që atje... Ikën ato vakte kur hante qeni petulla...»

Ti ishe larg dhe...

«Të tilla fjalë i dëgjoj sado larg që të jem, Desha ta nxirrja jashtë nga shtëpia, por të tjerët e panë rreptë dhe...»

Ai u largua vetë.

Po, atje, duke mbajtur radhën në dyqan, në stadium, në shëtitje, në...

— «Më kujtohen të gjitha...»

Me siguri edhe fjalët e pedagogut të mark-sizmit:

«...Ai ndoshta mund të mos ketë revolver e bomba me sahat në xhepa... Ai ka gjuhën bazonetë që helmon... Nuk del vetëm natën shtigjeve, por dhe në mes të ditës. Ai s'ka brirë, atij mund t'i rrjedhë mjaltë nga goja, por...»

«Po».

E, ç'dicitarë do t'i vesh kësaj fotografie?

NË UDHE

Ai kishte vënë bërrylin mbi mbështetësen mi-dis sediljeve. Mbi pëllëmbën e dorës i rëndonte koka me ato mendime e shqetësime të papër-imbajtura, që e lodhnin, e bënин të zyrtë, i thur-nin një perde të padukshme, që e ndante nga bashkudhëtarët. Sytë i kish ngulur përtej dritares, në një pikë, që lëvizte paralelisht me trenin... Shikimi i tij i përqëndruar diç gërmonte në lar-gësi e thellësi të panjohura për xha Zeqon, që kish në krah dhe për të tjerët. Kur treni iu afrua Durrësit dhe filluan të shpalosen fragmente kal-tërsie, shikimi i tij i menduar u shkul nga ajo pi-kë e padukshme dhe ra mbi detin, që valviste ca dallgë të lehta si tingujt e një ninulle. Mos va-lë e fshehta, që kërkonte ai, ruhej në ato thellësi të kaltërtat?

Shikova sytë e tij, por ata nuk më përgjigje-shin... Se ç'kuptova nga kthjellësia e ngrohtësia e tyre; ai do ta gjente të fshehtën, sado thellë që të fshihej...

Spikeri njoftoi nga qendra e zërit pasagjerët se arritën në stacion. Treni ngadalësoi shpejtësinë. Tani shikimi i tij u drejtua tek vinçat që zgjat-nin qafat e tyre mbi port.

Sytë e tij kërkuan një copë herë në atë shoëri kollosësh metalikë dhe u ngulën tek ai më i riu prej tyre të cilin s'kishte shumë kohë që e kishin vendosur në breg të detit punonjësit e portit. Ai buzëqeshi.

«Ata krijuan alamet vinçi, kurse unë...»

— Më merr edhe mua një paketë cigare, inxhinier, — porositi dikush një djalë të ri, që po zbriste nga vagoni. Ai që po shihte vinçat u kthyen menjëherë.

— Inxhinier, shoku inxhinier...

— Shyqyr që nxore një fjalë, o derëzi, ty sikur të janë mbytur gjemitë... Unë menjëherë të mora pér memec... Si s'e hape gojën or burrë i dheut... — qeshi xha Zequa...

Inxhinieri u afrua. Ai që i thirri e ftoi të ulej.

— Duhet të marr cigare...

— Kam unë cigare — dhe nxori paketen...

Inxhinieri u ul...

— Çfarë inxhinieri jeni ju? Domethënë pér ç'degë... Si të them, inxhinier ndërtimi a, mekanik a...

— Mekanik, mekanik... Veç, unë nuk jam inxhinier, po student në vitin e fundit të inxhinierisë...

— Ashtu hë? Po nejse... bukur fort... njëlloj është... A mund të më ndihmoni pér diçka...? Klam një mendim... E kam prej kohësh, po tani në tren sikur ja gjeta fillin më duket... Dua të modifikoj një presë... i rritet dy herë rendimenti...

— S'di sa mund t'ju ndihmoj, megjithatë...

— Sidoqoftë këshillohemi njëherë... Ju nga teoria... kurse unë... nejse... Ja... — Ai nxorri

një laps e diç nisi të skicojë mbi paketën e cigareve...

Pushimi mbaroi e treni mori përsëri rrugën mbi shina... Ata jepnin e merrnin mbi atë skicë të parregullt në paketë... Pasi mënduan një çast, studenti hoqi një vizë e shënoi një reth të vogël e të prerë në mes.

— Mund të bëhet — tha i entuziazmuar.

— Do të bëhet — pasoi tjetri — vec...

Përsëri ranë në mëndime me sy të mbërthyer mbi skicë...

— Ishte një u bënë dy gjemi mbytur — shpotiti përsëri xha Zequa. Ata s'e dëgjuan.

— Dy vinça që duan të nxjerrin një gjemi nga thellësitë — tha, pa iu drejtuar xha Zeqos, një djalë i ri, që ishte rëmbyer nga përqëndrimi i tyre në atë skicë të vogël.

Ata filluan të jepnin e të merrnin përsëri me njëri-tjetrin... Pastaj studenti hoqi cigaret, e grisi paketën e filloj të bënte ca llogaritje mbi faqet e saj të mbrendshme... Treni ndaloj në Rrogozhinë, shumë pasagjerë zbritën, shumë të tjerë hipën e treni nisi përsëri rrugën. Studenti ishte mbërthyer i téri mbi ato llogaritje, kurse tjetri po e kopjonte skicën në një copë tjetër të paketës...

— Do të bëhet — tha studenti dhe nënvizoi një shifër...

— Ana e poshtme e detalit duhet punuar më e ngushtë.

— Si?

— Ja, këtu, shiko — dhe i tregoi skicën.

— Dale...

— Duhet më e ngushtë kjo...

— Tamam! Kjo s'më shkoi ndërmend... Ja ç'do të thotë praktikë... Ta korrigojmë... — Dhe nisi përsëri të bëjë llogaritje...

— Ku do të zbritni ju? — e pyeti studentin tjetri.

— Në Rrogozhinë.

— Po... Ë?!. Sikur e kemi kaluar...

Studenti hodhi sytë nga dritarja, një çast sikur u hutua, pastaj qeshi...

— Një udhëtim shumë interesant... Do i'ju shoqëroj deri në Elbasan — dhe vazhdoi të shkruajë. Tjetri vazhdonte punën me skicën. Fytyrat e tyre ndritnin nga një buzëqeshje e ngrrohtë, e ëmbël dhe tepër miqësore.

Bashkudhëtari tjetër, që ishte ulur pas tyre, i tha një shokut të tij:

S'është çudi që ndonjë ditë këtu në vagon të zhvillohet ndonjë sesion shkencor.

H A S M I

— Shoku Qazim, po hiqe vallen de, hiqe. Jepi udhë se na le në vend. Hajde, ngrije — i tha i zoti i shtëpisë komisarit. Dhe filxhani pa bisht, mbushur përgjysmë me raki filloi të vijë përsëri rreth vatrës.

— Ne s'kemi ardhur për t'ja shtruar me raki, o Nuredin vëllai. E pimë nga një gotë epo hajde de, po jo kështu..! Këtë raki e shet e u merr ndonjë gjë fëmijëve — ja pat komisari, kur filxhani ra përsëri në dorë të tij.

— More po ju lumshin këmbët që më erdhët në shtëpi, pa këtë pikë raki që kemi do ta pimë se s'bën, sa të ziejnë fasulet. Juve ju ka hyrë të ftohtët në palcë, zjarri po, siç e shikoni, s'po bëhet për mbarë. Kështu që kjo e shkretë sikur ta ngroh barkun. Po hajde, ngrije, ngrije komisar — ngulte këmbë i zoti i shtëpisë.

— Epo, për shëndetin tënd, o mik. Të paçim gëzuar, — uroi komisari e ngriti filxhanin.

— Shëndet e gaz paçi!.. Shëndet pastë Partia mbi të gjithë — ja ktheu Nuredini. Filxhani përsëri nisi vallen. Kur Nuredini ja dha atij, që kishte zënë vend në cep të vatrës, një partizani trup-ngareshur e me prenka, gishtat e tyre u takuan.

Të zotit të shtëpisë i kërceu vetulla e majtë, u ngrit e iu ul disa herë, siç ngrihet e ulet toka, kur nën të shkom urithi.

Kështu i kërcente vetulla e i ndizej shikimi sa herë i jepte filxhanin Zenunit, partizanit me prenka, të cilin shokët e thërritin shkurt Zeno. Nga thellësia e qënjës së tij shpërthente një psherëtimë e thellë, që tretej brendaperbrenda.

Në këto çaste buzëqeshja, që ai u hidhte mysafirëve, ishte e ftohtë; ajo i ngjante reflektimit të rrezeve të diellit nga dëbora.

Partizanët kishin rënë pas muhabetit përmarshimin e fundit dhe s'e vinin re ndryshimin e humorit tek i zoti i shtëpisë. Edhe partizani me prenka s'e vuri re në fillim por një herë shikimet e tyre u ndeshën e ai vuri re se sytë e Nuredinit ishin turbulluar.

Partizani u hutua, ngriti supet e mbi fytyrë iu end një shprehje habie, përzier me një buzëqeshje naive.

— Ngrije, ngrije — i tha Nuredini, duke i bërë shënje me kokë për t'i treguar filxhanin që i kishte mbetur në dorë.

Zëri i tij nxori dhe një pjesë të asaj pshëritime të brendshme.

— U bënë fasulet o bijë. A t'ua sjell, a? — u dëgjua zëri i plakës së shtëpisë, që kishte futur vetëm kokën në të ndarën ku kishin zënë vend partizanët.

— Silli, sillë sa janë të vala — tha Nuredini dhe u ngrit e shtroi sofrën. Mori dy misérnikë e i ndau më katersh, duke i vënë mbi gju e duke u mëshuar. Partizanët zunë vend rrëth sofrës, e

ai u afroi nga një copë bukë. Edhe Zenuni ndeu dorën.

— Merre mik, merre — tha Nuredini dhe i zgjati copën e bukës.

Plaka u duk përsëri në derë me një tavë balte në duar, mbushur me fasule, që avullonin. I biri u ngrit, ja mori nga duart dhe e vu në mes të sofrës.

— Bujrum, o miq, e mirëse më kini ardhur. Kjo na u ndodh... — dhe Nuredini mori lugën.

— Mirëse të gjetëm, byrazer e buka mos t'u ndaftë nga sofra, — e uroi më plaku.

— A s'të ndodhet edhe një lugë tjeter, o mik

— i tha komisari dhe tregoi me sy Zenunin që po ngjyente copën e misérnikes në lëngun e fassuleve. Nuredini numëroi me sy lugët e drunjta.

— Mos u vëré në siklet, vëlla... Ja po hamë me një lugë me Kason — e mori fjalën përsëri partizani plak dhe i zgjati lugën Zenunit.

— Nënë... o nënë... — i bëri zë s'ëmës Nuredini.

Ajo s'u përgjigj.

— Merre timen — i tha Zenunit dhe i zgjati lugën. U ngrit nga sofra.

Zëri i tij Zenunit kësaj here iu duk më i ngrohtë dhe mendoi se Nuredini s'e kishte lënë me qëllim pa lugë, por mund të kishte harruar.

— Po rri, o Nuredin, se jemi mësuar ne... Kemi ngrënë edhe dhjetë vetë me një lugë — foli Komisari, po Nuredini doli pa kthyer fjalë.

Kur u kthye ai, partizanët e kishin gjysmuar tavën.

— Kot që u ngrite, për besë po, kot — i tha ai me mustaqe të verdha.

— Si ore... fjalë është ajo.? Urdhëroni... si në shtëpi tuaj... — dhe sytë i shkuant tek Zenuni, i cili i buzëqeshi... Nuredini uli kokën.

— Ka bërë fasule zamani nëna jote!.. i ka zier në poçë të mbyllur — hapi muhabet mustaqeliu. — E di ç'tregojnë pér poçen me fasule? Që thua ti, o vëlla, një mbret ka dhënë gjysmën e pasurisë pér një poçë fasule.

— Jo ore?! — u habit Nuredini.

— E ore, pér një poçë fasule gjysmën e pasurisë dha i biri i botës.

— E ç'nuk bën vaki, xhanëm... Apo është përrallë?

— Po ç'kujtove ti, se mos e ka bërë atë punë Ahmet Zogu, a... jo or jo...

— More, fasulleve u martë të keqen... Ai deshtë një poçë me ashtu, me nder... me baltë misri, se po hamë dhe bukë...

Partizanët ja plasën gazit... Qeshi me të madhe edhe Zenuni, po me të ndeshur në sytë e Nuredinit e qeshura i fluturoi si një flluske sapuni.

— Hajde, bromp me fasule, foli i zoti i shtëpisë dhe mbushi lugën. Së shpejti hëngshim në sofër të lirë dhe... Por një krismë e thatë pushke ja këputi fjalën në mës, e atij i mbeti goja hapur.

— Ç'të ketë ndodhur? — pyeti komisari.

— Si pushka e Faros më duket — tha Zenuni. Pushka u dëgjua edhe një herë.

— Thashë unë, ajo zëngjirura e Faros është...

— Rrëmbeni armët, shokë!..

Në derë u duk një partizan i ri, një çunak
16-17 vjeç.

— Shoku komisar...

— Ç'ndodhi Naum?

— Një tufë nga derrat e Ballit na kanë diktuar e po rrrethojnë fshatin.

— Shpejtoni shokë!

— Gati jemi.

Dhe partizanët dolën pa harruar të falenderonin të zotin e shtëpisë për pritjen e tij bujare. Gjithshka ndodhi vetëtimthi e Nuredini shtangu një çast pa ditur ç'të bënte.

S'kaluan disa minuta e krisi pushka.

Në kasollet e fshatarëve filloj të futet era e barutit, që prishi ajrin e lagësht të asaj mbrëmjeje dhjetori. Nuredini u suall një copë herë nëpër shtëpi pastaj veshi opingat e doli. Me të dalë në oborr dëgjoi fare qartë fishkëllimat e predhave. Ku të drejtohej? Armë s'kishte, vendin ku ndodhej komandanti ose komisari s'e dinte.

— Po si nuk ika bashkë me ta, e hëngërt dreqi. Mos më marrin për ndonjë mik të ballistëve! Si m'u lidhën këmbët, dreqi e marrtë... — bluante me vete, aty pas gardhit të një kopshti.

Një partizan me automatik në duar kaloi me vrap para tij.

— O partizan! A e di ku është komisari? — e pyeti Nuredini.

Partizani e vërejti.

— Ishin në shtëpinë time, po krisi pushka e s'e di ku kanë zënë vënd — u shpjegua Nuredini.

— Hajde pas meje — tha partizani dhe ja dha prapë vravit. Nuredini u nis pas tij. Por pa arritur akoma atje ku ndodhej komisari partizanët u hodhën në sulm.

— Tani s'ke ku e gjen komisarin... kthehu

në shtëpi më mirë... — i tha partizani me automatik në duar dhe humbi në errësirë drejt krismave, që sa vinte dëgjoheshin më pak.

Nuredini nxori qesen prej lëkure dhe drodhi një cigare të trashë.

— Kushedi çdo mendojnë për mua... Këmbëlidhur derdimeni... — grindej me vete dhe mbasi ndezi cigaren u nis më hap të ngadaltë për në shtëpi.

«E morën bishtin ndër shalë qenët» tha me vete duke dëgjuar krismat, që sa vinin e bëheshin më të shurdhëta. Si bëhej të hynte në shtëpi. U ul mbi një trung lisi të gjerryer nga krimbat, aty para shtëpisë. Humbi në mendime.

— Hajde brenda, mor bir... luftë është kjo e shkretë. Hajde brenda, — dëgjoi ai zërin e s'ëmës, që i qe afruar si një hije.

— Dëgjo, dëgjo. Po e thyejnë qafën ballistët, po marin bishtin ndër shalë...

Plaka kryqëzoi duart mbi bark e nguli sytë në errësirë, andej nga vinin krismat. Papritur feksën tri raketa të kuqe. Plaka u drodh.

— Hajde brenda bir, luftë...

— Shko ti, shko... e fli pa merak se u pa puria e tyre, i tha Nuredini.

Mbas ndonjë ore krismat e fundit i përpiu natë. Ballistët kishin ikur nga sytë këmbët.

Nuredini drodhi dhe një cigare tjetër sa gishti i madh i dorës.

— Hej, shokë... mblidhuni te bregu, — thirri dikush larg. Nuredini u çua.

— Te bregu!..

— Te bregu... — përsëritnin partizanët në drejtime të ndryshme.

— Te bregu, — tha me vete edhe ai e u nis drejt vendit ku do të mblidhej kompania.

Nëpër errësirë filluan të duken siluetat e partizanëve.

— E? — pyeti Nuredini të parin, që i kaloi pranë.

— Ju dhamë një mësim që s'do ta harrojnë kurrë, ua thyem hundët.

— I mbushiën brekët — ja pat një partizan bojali që mbante mbi sup një mitroloz të rëndë.

— Po komisari ç'u bë? — pyeti përsëri Nuredini.

— Aty ishte matanë, nga boka... Ja, ku po duken ca hije, mos është me ta...

Dhe ai u nis t'u dilte përpëra siluetave, që sa vinte e merrnin trajta më të plota.

Dhe vërtet komisari ishte me grupin e partizanëve që zbritnin nga boka. Vetëm kur dolën te bregu, Nuredini vuri re se ata mbanin ndër duar dy shokë.

Nuredinit i theri në zemër, e aty për aty nuk guxoi ta pyeste komisarin, i cili ashtu si edhe partizanët e tjerë dukej pik e vrer.

— Qenkan vrarë — pëshpëriti Nuredini dhe u nis pas partizanëve. Ata ndaluan pranë disa shkurreve, pas të cilave mbështetën armët.

— Kujdes! u dëgjua zëri i komisarit.

Partizanët lëshuan ngadalë shokët që mbanin në duar, sikur të ndruheshin se mos i zgjonin prej gjumit.

Një çast u bë heshtje. Dy partizanë u përkulën mbi njërin prej shokëve.

— Qemal... dikush foli.

I plagosuri rënroi... Ata i çkopsitën gjoksin.
Nuredini u afrua.

— Mos ju duhet ndonjë gjë për të plagosurit?

Me sa duket ai foli shumë ngadalë, e s'u përgjigj njeri.

— T'i shpiem të plagosurit në shtëpi më mirë,
— tha përsëri ai.

Partizanët ktheyen kokën.

— T'i shpiem në shtëpi më mirë, — tha Nuredini.

— Merreni, — tha komisari.

Partizanët e ngritën të plagosurin. Ai nxori një rënkim të mbytur.

— Mbahu Qemal, — e qetësoi partizani mustaqeli.

— Po tjetrin — pyeti Nuredini komisarin.

— Ai ka mbaruar.

— Ka vdekur?

— Na mbaroi në duar.

— Oh, të poshtrit!

— E mori në zemër plumbi.

— Po ai tjetri, që e morëm tanë?

— Rëndë është, po s'ka irrezik.

Komisari u përkul mbi të vrarin dhe ra në mendime.

— A e paguan qenët të paktën?

— Nja dhjetëve ua dëgjuam të pallurat e vdekjes vetëm në sektorin tonë. Vetëm ky i palosi nja tre a katër me këtë birkon — dhe komisari bëri me kokë nga mitralozi që ishte vendosur te kryet e të vrarit.

— Ishte trim, hë?

— S'kishte shok, — ai s'ja ndante sytë parti-

zanit që heshtëte, shtrirë në lëndinën e lagur, — Besa s'kishte shok... Xhevahir ishte. Gjithmonë i queshte buza. Komisari ndezi çakmakun dhe i ndri-çoi fytyrën.

— Shiko, edhe i vdekur duket sikur qesh.

Nuredini zgjati kokën.

— Zuela!... Shtangu i habitur.

— I mbeti peng që ti u solle me atë ndryshe nga ne të tjerët. Edhe kur u nisëm t'i ndiqnim ata zabérhanat më pyeti, po s'dija ç't'i thosha. I mbeti merak...

Nuredini kaloi tri-katër herë me zhurmë pësh-tymën; përsëri i kërceu vetulla e majtë.

— E botë, o botë!

— Një pushkë më pak, — shfryu pikëllimin e thellë komisari. — Një pushkë e fortë më pak në kompaninë tonë.

— Pushkët janë tamam, shoku komisar.

Komisari zhytur në atë pellg trishtimi mezi e kapi fillin e fjälëve të Nuredinit.

— E si, tamam pushkët?

— Në këmbë të tij më kini mua, shoku komisar. S'di a do të bëj aqë punë sa bënte ai, po di të them këtë, o shoku komisar, s'do të lë kusur, Nuredini mori mitralozin që rrinte në kryet e të vrarit, i ra tytës me pëllëmbë, siç i bie fshatari qafës së kalit të tij që s'e lë kurrë në baltë.

— Ta mbash më nder, o Nuredin, e të mos e tur përosh armën...

— Shoku komisar...

— Shikoja dhe një herë fytyrën, që të mos e harrosh kurrë këtë trim. — Ai ndezi përsëri çakmakun e përsëri vërente me kujdes tiparet më copa hijesh, që luhateshin sipas luhatjes së flakës.

— E mor shoku komisar. Unë mund të harroj edhe nënën time, po këtë sa të kem jetë s'e harroj dot... Më lidh gjaku, shoku komisar — dhe pshërtiu. — Gjaku...

— E paske tëndin Zenunin?

...

— Po ai s'tha gjë!

— E kisha hasëm, shoku komisar.

— Hasëm? Komisari brofi në këmbë.

— Po, hasëm e kisha. I jati i tij më ka vrarë babanë dhe vëllanë e madh.

— Përse?

— E... e... Përse!? Për një bisht gomari... Për mustaqet e Çelos, komisar,...

— Cudi!

— Unë kam dashur ta vras Zenunin. Bile dy herë i zura edhe pusi, po s'më doli në shteg...

— Prandaj e haje 'me sy kur i jepje gotën e rakisë...

— Më ra shtëpia në kokë kur e pashë që hyri në derë, po s'e bëra veten. Po kur i dhashë filxhanin në fillim m'u ndez gjaku e m'u frynë damarët... m'u duk sikur ma vrael për së dyti babanë e tim vëlla.

— Cudi e madhe... Po s'm'u duke edhe aq i tronditür, bre burrë!.

— E kisha në shtëpi pra, e kisha mik, pastaj e pashë edhe partizan dhe inati sikur m'u fashit.

— Po ky s'dinte gjë?

— Nuk më njihete fare siç duket. Ky ka qenë i vogël kur u futëm në gjak. Pastaj i jati vdiq e këtë e rriti tezja... Në një fshat nja tetë a nëntë orë larg që këtej.

— G'ka hequr ky popull..!

— Më rëndon zemra si ndonjë shkëmb, o shok komisar, e më dridhet mishi nën lëkurë...

—

— S'ma pat marrë mendja de, se mund të bë-hem vëlla me hasmin.

Komisarit i shkuan mornica.

— Po s'di për nga zotësia a do t'i vij për krah, a do ta nderoj dot — vijoi Nuredini.

— Ja ku të them unë që ke për t'ja kaluar tënd vëllai. Ai ka grirë ballistë e gjermanë, po ti ke fituar një luftë më të zorshme, o Nuredin. Ti vrave hasmin... atë zakon të egër që na fuste në gjak vëlla me vëlla që na është shtruar prej she-kujsh në vatrat e na ka lëshuar rrënjet në palcë të trupit e në mes të zemrës.

URATA

Për herë të parë në jetën e tij të martesës uratë Stasi i tha së shoqes që të flinte në dhomën tjetër e ta linte vetëm. Ai u suall një hop nëpër dhomë, herë me duar të kryqëzuara mbrapa e herë duke krojtur mjekrën. Pastaj u ul mbi shtrat. Diç pyeti veten, diç i tha vetëvetes në vend të përgjigjes... Përsëri krojti mjekrën... Bisedoi gjatë kësh-
tu me veten, herë duke pyetur e herë duke u përgjigjur e duke krojtur mjekrën pas qdo pyetjeje. Mesnata kishte mbështjellë në krahët e saj gjith-
shka, por derën e Stasit e harroi atë natë. Ai filloj-
të sillej nëpër dhomë. Pastaj iu afrua pasqyrës. Që
atë ditë kur kishte veshur për herë të parë rrrobën e
priftit s'e kishte parë kurrë veten me aqë kujdes
në pasqyrë si atë natë. Hoqi kamillafin nga koka
dhe me dorën e majtë mbajti një çast të mble-
dhura flokët e gjata, që i hapeshin mbrapa. Shtrëm-
bëroi buzët. Me dorën e djathjtë u mundua të fshih-
te mjekrën.

— Si cjap i qethur — tha me neveri për atë që
shihte në pasqyrë, të cilin ende s'vendoste ta quan-
te Stas. Sillej sa sillej nëpër dhomë, ulej mbi jata-
kun e butë, dy pëllëmbë të shtratit i cili për
herë të parë i dukej sikur ishte mbushur me lesh

gjithë rrodhe, e shkonte përsëri te pasqyra. Shkoi nëpër mënd deshijtë, që ja kujtonin postiqet e shtruara rrëth e qark dhomës, meshat, dhuratat e besimtarëve... por mëndja i rrinte orë e çast tek ai burri me mollëza të kërcyera, me sy të futur thellë zgavrave, pa flokë të gjata e pa mjekër, që i qëndronte përballë, në pasqyrë. Nejse... Do bënte si do bënte edhe ai... ashtu si të gjithë... Vecse fytyra e atij, që i dilte në pasqyrë nuk i pëlqente. Sesi i dukej. Kur mbulonte mjekrën me duar, ndjente një mungesë të madhe, sikur t'i mungonte një gjymtyrë...

Gjithë natën uratë Stasi bëri gjyq me veten e, kur tej nga kodrat e Buallit u ngrit një kind i napës së natës, u nis pér në kishë. Ndezi një gjysmë qiriri, që kishte mbetur mbi shandanin e vjetër, pastaj u suall nëpër kishë pa ditur ç'të bënte. Një çast qëndroi me shpinë nga qiriri dhe vuri re hijen e tij të stërmadhe, që projektohej në murin përballë. Hijen e çante përmes një shirit i dobët drite, që hynte nga dera. Atij iu duk sikur ai shirit e tërhiqte, e tërhiqte fort e ai instinktivisht u pëshoi këmbëve. Shpuri duart mbi mjekër, sikur do të mbahej pas saj...

Përsëri gjyq me veten e me figurat e ciflosura të shënjtoreve. Ata pyetnin në heshtje dhe përgjigjeshin po me atë heshtjen e tyre të akullt e të pafund prej shënjtori. Stasi mbuloi mjekrën me duar dhe i pa të gjithë me radhë. Ata përsëri e panë si shënjtorët.

— Si cjad i qethur — tha me vete Stasi. — Po ju s'kini pér të më parë... S'do shihemi më... Tani nga dera dhe nga dritarja e vogël der-

dhej në kishë gjithë drita e mëngjezit, e qiriri dukej si një bisht cigareje. Në të fikur. Stasi u afroa dhe i fryu. Ndoqi me sy atë fjollë tymi të vogël, që u ngrit nga shandani dhe u mat të dalë. Te dera u ndal. Zgjodhi një vend të mirë, si fotografi kur do të marrë një kuadër të plotë. I nguli sytë mbi gjithshka që ndodhej në kishë, edhe në vogëlsirat që s'i kishte vënë re kurrë. Fotografoi në kujtesën e tij gjithshka të ftohtë, të vjetër, të zbetë, që kishte në atë dhomë, së cilës i vinte era myk. Stasi s'e kuptoi se era e mykut buronte edhe nga rrobat e tij të zeza e të dala boje, edhe nga kamillafi, edhe nga tmjekra...

— Po iki — foli mbyturazi Stasi pa ditur kujt i drejtohej, vetes, shënktorëve, mykut apo diellit, që kish filluar t'ja ngrohte shpatullat aty në prag të derës.

— Njëzet e gjashtë vjet — tha përsëri, kur i vuri çelësin derës. — Një-zet- e gjash-të vjet... — i ndau fjalët rrrokje-rrrokje, duke tundur kokën.

Duke ecur nëpër atë tunel mendimesh të amullta arriti në zyrën e kryetarit të kooperativës. Kryetari e priti buzëgaz:

— Hajde, uratë, hajde — dhe i zgjati dorën.

Atë çast Stasi ndjeu se i kishte djersitur dora e djathëtë ku mbante çelësin, por u zu ngushtë e s'kish q'bente. E kaloi çelësin në të majtën dhe i zgjati të djathëtën kryetarit.

— S'të vura re, hyre me këmbën e majtë apo me të djathëtë, se tani jemi në të mbjellat e mbase na sjell ndonjë fat të mirë — e ngacmoi kryetari, por prifti, që e kishte pasur zakon t'i kthente thumbat aty për aty, s'foli.

— Po ulu, ulu — ndërroi ton kryetari, kur pa se diçka kish në këtë mes.

— Erdha të sjell këtë — iu zgjidh gjuha priftit dhe i lëshoi çelësin mbi tryezë... — Përdoren i pér depo o pér çfarë duhet... S'prita që të vinte rinia e të më vente ndonjë nga ato rrufetë e kuqe, andaj erdha ta dorëzoj vetë... — U mat të vazhdonte më tej, po goja i mbeti hapur e ndërroi mendje, ktheu shpinën e doli. Kryetari hapi dritaren e i thirri dy-tri herë, por ai s'i dha përgjigje.

— Ne vritnim mendjen që të gjenim depo pér pluhur kimik, kurse urata erdhi si me porosi... — qeshi kryetari duke parë si lëkundej çelësi varur në gjalmin e tij prej leshi, të cilin kryetari e mbante me dy gishta lart.

Ditët e para mbas dorëzimit të çelësit, mëngjëzeve e mbrëmjeve, kur fshatarët shkonin e vinin nga fushat, urata s'para dilte nga shtëpia. Se ç'ja zinte këmbët në prak të portës. Sillej nga sillej e dilte në dritare. I ngulte sytë asaj ndërtese të vjetër, aty në cep të fshatit, mbuluar me plloça, që tashmë ngjanin si një lëndinë nga kadifja e gjelbër e myshkut, që kishin rritur vitet.

Por ditët shkonin e Stasi filloi të mos shihët më ëndrra të këqia, bile sikur po e harronte kishën. Veç mjekra i rëndonte.

— Po bëhem derr, po pëlcas — i thoshte nga njëherë së shoqes. Dhe një mbasdite, aty më të ngrysur, shkoi në zyrat e kryesisë. Kur pa nga dritarja e zyrës së kryetarit se aty kishte shumë njerëz, u mat të kthehej, po këmbët s'iu bindën.

Hodhi një «mirëmbrema» të ftohët mbi kokat e atyre që ishin në zyrë, por nga ftohtësia e saj

mbinë buzëqeshje në fytyrat e të gjithëve.

— Urdhëro e ulu, uratë, — i lëshoi vendin një djalë i ri, dhe i shkeli syrin një tjetri. Kryetari nëpërmjet buzëqeshjes i hodhi një shikim qortues atij që foli.

— Po ç'u bëre, mo xha Stasi — i tha pastaj të porsaardhurit. Kishte kaqë vjet që s'e kishte dëgjuar emrin e tij nga goja e fshatarëve. Zëri i kryetarit sikur e përkëdheli brenda, në gjak.

— Besa u bëra deir, o shoku kryetar... S'rrihet tërë ditën e perëndisë... — Djali që i pat lëshuar vendin qeshi me zë. Stasi u bë nervoz me veten. Shtoi:

— S'rrihet tërë ditën e ditës si hu në shtëpi... Prandaj kam ardhur, që thoni ju, mos më bëni dhe mua ndonjë vend në kooperativë.

— Edhe ne pritnim, e sikur mos kishe ardhur vetë, do të vija unë në shtëpi... — i tha kryetari. — Kooperativa derën hapur e ka... Po të duash që nesër...

— Le të vijë në brigadën tonë, xha Stasi — tha ai djali i ri, që kish qeshur me zë pak më parë.

— Më mirë me pleqërinë, o kryetar, me djalërinë s'e ha dot unë... Pastaj këta do të më nga-sin, duan të më nxjerrin e të më shohin zorrët e barkut... Kurse unë... u bë ç'u bë i vura kapak asaj pune. Prandaj... me pleqërinë... më mirë.

— Do të të mbajmë në pëllëmbë të dorës, o xha Stasi... Do të bëjmë edhe ty të ri. Pastaj edhe ne kemi pleq në brigadë — nguli këmbë djali. Stasi ngulte këmbë në të tijën... E mbasi u bisuedua gjatë kjo punë, u vendos që të shkonte në brigadën e të rinjve.

— Kisha edhe një lutje tjetër, shoku kryetar — tha Stasi, si u vendos në ç'brigadë do të punonte.

— Folë, xha Stasi...

Të gjithë kthyen kokën nga ai.

— Nejse, një herë tjetër, një herë tjetër...

— Po thuaje, thuaje, ne tanët jemi... ç'hall ke?

— Një herë tjetër, s'ka gjë, një herë tjetër...

— dhe doli.

Të nesërmen Stasi u ngrit që me gjelin e parë. Ndezi dritën dhe mori pasqyrën. Vuri kasketën, që e kishte blerë një ditë më parë. E vinte majtas, djathtas, e ngrinte strehën lart, e ulte poshtë... S'i flinte mendja. Po mjekrës si t'ja bënte?

— T'i kisha thënë mbrëmë kryetarit, do ta kisha më lehtë... E po të më ngitnin djemtë, ua zija gojën më fjalën e kryetarit. Atë mëngjez as që i shkoi kisha nëpër mënd, veç mjekra i rëndonte.

— E po këtë s'e heq or jo, sikur kjamjeti të bëhet — i tha vetes dhe doli nga shtëpia.

Ditët e para djemtë e brigadës nuk e ngacmonin, veç qeshnin nën buzë, kur e shikonin të punonte e t'u hidhte nga një shikim vjedhaz duarve që kishin filluar t'i fluckoseshin. Të rinjtë e ndihmonin, s'e linin që të lodhej shumë. Stasi s'ngopej me afshin e tokës, gudulisjen e të cilit e ndjente në gjak.

Ai kënaqej, sikur i shpiheshin damarët, kur mbushej me frymë; veç kur ndonjëherë kraharori i ngrihej shumë e i takonte mjekrën e ashpër, ai shihte djemtë.

— S'po më ngasin, jo — thoshte me vete i lehtë-suar — e harruan punën e mjekrës.

Por ja që ata s'e kishin harruar. Kur Stasi u fut disi në vallen e punës, një drekë kur po hanin bukë Maqka i Peços s'e mbajti më:

— Mirë, o xha Stasi, ti hoqe dorë nga prift-lëku, po mjekrën ç'e mban akoma?

Stasit i mbeti kafshata në fyt, iu duk sikur ai e kapi përmjekre dhe e tërroqi fort.

«Filloi avazi» — mendoi me vete dhe vazhdoi të përtpej.

— Budalla që bëhesh — u hodh një tjetër — po tashti dimri kaloi, xha Stasi e mban mjekrën gjër në vjeshtë, pastaj i këput një të qethur e bën një palë çorape që as plumbi të mos i shpojë.

Stasi përsëri e kapërdiu përgjigjen me kafshatën e bukës.

Djemtë tani s'pushuan gjersa lanë punën.

«S'do t'u jap xhevap fare, do japid, do japid e do lodhën», vendosi Stasi.

Po ata s'u lodhën. Të nesërmen në brigadë muhabeti vinte nga vinte e kthehej te mjekra e tij. Të pasnesërmen po ashtu. Stasi po pëlciste nën lëkurë. Një ditë u nxeh aqë shumë, sa me t'u kthyer në shtëpi mori gérshérët e u bë gati ta priste, por mbeti ashtu me mjekër të mbledhur në pëllëmbë të dorës e me gérshérë të hapur.

— Si cjak i qethur — belbëzoi dhe e la gérshérë. Shkuan ditë të tjera e Stasi u mësua me romuzet e djemve, nuk u zemërohej më. Ai, megjithëse bashkë me dorëzimin e çelësit të kishës kishte vendosur të humbiste edhe çelësin e asaj dhome të kujtesës ku ruheshin gjithë bëmat e tij si prift,

prapëseprapë s'u mbajt më e nisi t'u tregon te
djemve, në fillim disa gjëra të vogla e pastaj edhe
sekretet e tij më të mëdha, filloi pra t'u hapte
barkun djemve.

— Se ç'kanë këta qerratenj një marifet e m'i
nxjerrin fjalët si me çengel — i thoshte mbrëmave
së shoqes.

Kështu, tani çdo ditë mbasi hanin drekë ishte
bërë zakon që xha Stasi të hapte depon e xhevahireve.
Djemtë shkuleshin së qeshuri. Me kohë
edhe ai vetë s'e mbante të qeshurën.

Një ditë Maqka i Peços i tha:

— Xha Stasi, kemi një propozim. Hajde dhe
ti me ne në estradë.

— Ç'të bëj unë atje?

— Të lozësh, si ne.

— Të isha i ri, a? Do vija që ç'ke me te. Po
tani s'jam pér atë punë.

— E po atëhere na jep lejë pér diçka?

— Veç pér këtë mos kërkoni gjë — dhe tre-
goi mjekrën.

— More po atë gjer në vjeshtë e mbajç me
shëndet, po a do na japësh lejë që ato xhevahiret
e tua t'i nxjerrimi në estradë?

— Ç'thuua xha Stasi?

— Tashti puna ime u pa... bëni si të doni...
Po pa më thoni, si do t'i nxirrni atje në estradë?

— Do të bëjmë ato që ke bërë ti!

— D.m.th. do të më nxirrni mua.

— Kur ishe prift.

— Priftin do ta luajë Kozmai i Gaqos... Apo
s'të ngjet?!

— Do ma nxini faqen para fshatit, hë rrufjanë! Po mirë, bëni ç'të doni, unë tani...

Ç'është e vërteta prega titjet për estradën kishin filluar, ata e pyetën Stasin vetëm që të mos i mbetej qejfi.

Mbas nja dy-tri javësh shfaqja ishte gati. Veç një gjë u mungonte, mjekra për atë që do të luante rolin e priftit. U munduan ta bënин me lesh dhije, me lesh delje po s'u doli gjë. U lodhën duke kërkuar mustaqe të bardha misri në parcelat, po edhe kur i gjetën s'bënë dot gjë. I kërkuan ndihmë edhe xha Stasit që t'u bënte një mjekër, po ai tha se s'e bënte dot.

Djemtë u mërzitën se pa mjekrën shfaqja nuk do t'u dilte gjë. Po s'kishin ç'bënin, afishen e kishin vënë e të djelën fshatarët do të shkonin në shtëpinë e kulturës për të parë shfaqjen. Vendosën të linin atë mjekrën prej lesh dhije.

Dhe të djelën në mbrëmje salsa e shtëpisë së kulturës u mbush plot. U hap perdja. Në skenë u duk një kishë e vogël, tamam si ajo e xha Stasit. Pastaj u hap dera e prej andej doli «prifti». Në sallë shpërthyen të qeshurat:

— S'i ka lënë gjë uratës sonë, — thirri dikush.

— Po mjekra, shikoni mjekrën... Më duket se është xha Stasi, dora vetë...

Dikush u kollit fort. Spektatorët kthyen kokën nga fundi i sallës. Në gjysmë errësirë dallohej mjekra e bardhë e porsarruar e xha Stasit, si një copë luadhi i porsakorrur. Ai si duket kishte ardhur i fundit e kishte mabetur në këmbë. Gazi u ndez akoma më shumë. Spektatorët për një çast e harruan shfaqjen e mbetën me fytyrë nga Stasi...

sikur të pritmin fjalën e tij. Dhe ai e ndjeu se duhej
të thoshte diçka.

— Mos thoni se tek unë s'ka asgjë të vlefshme.
Edhe unë bëra një punë të mirë në jetën time, si
prift, dhashë... mjekrën time... — dhe i dha vetë
zjarr gazit...

PER ATO TE QOSHES...

Gjithmonë në qoshe, kudo në qoshe. Ishin dy, nënë e bijë: një nënë e plotpushtetshme, një bijë që dukej e nënshtuar ndaj s'ëmës. Ishin banoret më të reja të këtij qyteti malor. Nëna kënaqej duke menduar se ato ishin gjallesat më të heshitura e më të strukura të këtij oazi plot jetë në mes të kurorës së maleve. Askush nga banorët e këtu-shëm s'e kishte parë ende buzëqeshjen e tyre. Kurse trishtimin e njihnin me rrënje, sepse gjumat e tij i linin kudo nëpër këtë qytet të vogël.

Vajza ishte farmaciste. Me të mbaruar fakultetin e emëruan këtu në P... Kjo për nënën e saj ndoshta ishte fatkeqësia më e madhe në jetë. Ajo trokiti në të gjitha dyert e miqvë, por dyert hesh-tën. Ajo i luajti gjithë gurët, të mëdhenjtë e të vë-gjëlit, por nën asnjérin prej tyre nuk e gjeti çelësin për të hapur një derikë tjetër përfatim e së bijës... E... vajza u detyrua të paraqitej në detyrë me një muaj vonesë.

Dhe erdhi këtu, në qytetin midis maleve... Po si mund të vinte vetëm ajo në këtë vend të egër, që ka veç një monedhë quell mbi krye? Si do të jetonte ajo fillikat këtu ku syri të zë vec shkëm-binj malesh e njerëz shkëmbinj të malësive...

Q y q j a !

Dhe nëna u nis bashkë me të bijën. Rrudhja e buzëve filloi që në udhë. Autobusi i tyre ishte mbushur me malësorë. Një xhaxhushi mustaqebry-mosur që ishte ulur në krah të nënës i kutërbonte era djersë prej rrobeve. Nëna e pa shtrembër dhe vuri shaminë në hundë. Në stacionin më të afërmato ndërruan vend e shkuan në fund të autobusit, në qoshe.

Kjo ishte qoshja e tyre e parë në jetën mësore.

Qoshen tjetër e zunë në hotel.

Xha Noci, hotelxhiu plak i çoi në një dhomë treshe. Natën e parë bashkë me to fjeti dhe një vajzë fshatare, që kishte zbritur për mbledhjen e komitetit të rinisë.

— Interesant, çfarë temperamenti kanë këto malsoret — tha vajza që kishte fjetur tok me to. Nëna rrudhi buzët për së dyti.

Në dhomat fqinjë, deri vonë, ishin dëgjuar bisedat me zë të lartë të malësorëve. Në korridor dikush kishte këputur një të sharë vence... Nëna kishte kafshuar buzën. Në mëngjez i kërkoi xha Nocit që t'i conte në një dhomë tjetër, në qoshe, dhe të mos i ngatërronte me të tjerë.

Por edhe dhoma e qoshes, megjithëse ishte më pak komode se të tjerat, kishte tre shtretër.

— Uf....f — bëri nëna.

— S'kena dhomë dyshe, ej motër!

— Fundja po e paguajmë dhomën për të tre shtretërit, veç mos na sillni njeri në dhomë.

— Besa sun e baj dot... Gati çdo ditë bien

në qytet prej katunesh çika e gra, s'kam se ku i fus. — Mandej... — Xha Noci iku pa e mbaruar fjalën.

— Ç'na gjeti! — tha nëna — Po sidoqoftë jemi në qoshe...

Zbritën në restorant. E gjetën mbushur me malësorë.

I erdhi pështirë nënës nga ai valëzim i çrre-gullt i qelesheve të bardha, disa të zbrujtura nga djersa. Malësorët hanin dhe qeshnin, hanin dhe bisedonin, hanin dhe as u hidhnin sytë atyre, që kishin shtangur në derë. Tryezat ishin të gjitha të zëna.

Ato pritën sa u lirua një tryezë e fundit, në qoshe, dhe zunë vend aty; duke u ulur me fytyrë nga muri e me shpinë nga malësorët.

Kur shkoi kamarjerja për të marrë porosinë, nëna i tha:

— Do t'ju lutesha, në qoftë se do të ketë mundësi, që çdo ditë në orën 13 të na e ruani neve këtë tryezë.

Ju lutem... Ju e kuptioni...

— Tek ne s'ka vende të rezervueme, han ai që vjen ma parë.

— O Gjelinë, — thirri dikush.

— Erdha Nikollë — u përgjegj kamarjerja.

— Çdo të merrni — tha kamarjerja pas pak

— ka mish me qepë, me patate, me groshë, makarona...

Ato mendoheshin...

— O Gjelinë!

— Po ec, hej dreq!

— Ma bjer pra mishin me groshë!

— Erdha — ua kthente pa u mërzitur kamarjera. Nëna kujtonte restorantet e Tiranës dhe i vinte pështirë nga kjo klientelë e çuditëshme.

— A keni me hangër ju? Këtu s'ka kohë me u mendue shumë. Më në fund ato porositën. Nëna s'guxonte të kthente kokën.

— Shyqyr që jemi në qoshe, se ndryshe... Të paktën këtu në qoshe... — tha nëna.

Dhe kjo ishte qoshja e tyre e tretë.

Preokupimi kryesor për nënën ditët e para ishte pikërisht zgjedhja e qosheve, qosheve ku do të lëshonte pikat e veta rrjedha e jetës së tyre. Kaluan dy-tri javë dhe banorët e qytetit të vogël u mësuan më nënë e bijën e qosheve, kurse ato ashtu si ditën e parë s'ishin njohur me asnje të këtij qyteti, veç me qoshet e tij.

Një ditë, duke dalë nga restoranti, vajza pa një të njohurin e saj, kushërin e një shoqes, që kishte patur në kurs. Ai u afroa drejt tyre. I dha gjithë respekt dorën nënës. Ajo i lëshoi një fragment buzëqeshjeje, që s'i dukej as koka e as fundi, e që u zhduk si flluskë sapuni... Kurse dorën e vajzës ai e mbajti gjatë në pëllëmbën e tij, ndërsa bisedonte me të. Nëna pa u vënë re pickoi të bijën... Kjo filloi të skuqet në fytyrë. I kërkoi të falur të njohurit dhe u ndanë...

— Është gjeolog, diku këtu afér — tha vajza.

— Të pëlqen!? — E fshikulloi nervoze eëma.

Vajzës i dogjën faqet, por s'i përgjigj.

Një ditë tjetër ajo i ktheu me kokë pëershën-detjen një malsori të ri, të cilit i kish dhënë barna disa ditë më parë, e sic duket ato kishin bërë efekt. Por i kushtoi shtrenjtë. Eëma e hëngri me sy dhe ckërmitti dhëmbët në mënyrë kërcënuese.

— Fillove të hapesh si vaji në armé... po mbledh mendjen, çupë... ë... unë s'kam ardhur këtë... — i tha nëna mbasi kishin bërë disa hapa në heshtje.

Edhe gjatë orëve që e bija ishte në punë mamakja mbinte tek dera e farmacisë së vogël. Të më besoni, deri më sot ende s'e kam parë as edhe një herë vetëm, farmacisten e qytetit tonë. Ajo lëviz si miza nën rrjetën e merimangës, që s'i ndahet asnjë hap.

Tani nëna, me sy gjysmë të myllur struket nëpër qoshet e qytetit tonë; gjithmonë e zhytur në një lumi të thellë mendimesh (që çudi si nuk e lodhin). Është gjithmonë e heshtur... edhe me të bijën.

Habitem si nuk e ndjen nevojën e të biseduarit. Le që s'ka pse të habitemi. Po kërmilli me kë bisedon gjatë dimrit, myllur atje në guackën e vet...? Dimrit edhe kërmilli kërkon qoshe për t'u struktur... Nejse... nuk desha të bëja paralelizëm, po të paktën gjendja e jashtme më shtyn....

Trikot që veshin nënë e bijë dëshmojnë për një fantazi të mprehtë e shije të hollë. Po qyteti ynë s'ua ka parë shtizat në duar. Megjithatë ajo punon, punon si kurrë ndonjëherë, veçse nuk thur triko, por tërkuza të gjata, tërkuza të pafund mendimesh, tërkuza që lidhin qoshet e shpërndahen në drejtime të panjohura.

Harrova t'ju them se nëna nuk ha kurrë me lugët e restorantit. Në fillim disa ditë këtë e bëri dhe e bija, por më gjatë nuk mundi ta vazhdojë. E ëma e qortoi rëndë... Patën edhe grindje, por vajza nuk e nxori më lugën nga çanta...

— Filloi shkarja... një në dorë... Priti më të mëdhatë tani — thoshte nëna duke vazhduar të përdorë lugën dhe gotën e saj personale, që i mbante gjithëmonë në çantë, në një qoshe.

Ju keni dëgjuar e keni lexuar për shumë roje, që dallohen për zellin, gatishmërinë dhe mprehtësinë e tyre. Por nëna, që rri qosheve të qytetit tim, është një tip i veçantë rojesh, me nuhatje të çuditshme e me horizont të gjerë të të vërejturit. Asaj s'i shpëton asgjë nga detyra që i ka vënë vetes. Syri i saj ka një kënd absolut të të parit, veshi i saj kap dhe përshpëritjen më të ulët, kurse truri i saj si një laborator elektronik përpunon gjithshka në mënyrë të rrufeshme.

Ishin duke ngrënë drekë, si gjithmonë në qoshen e tyre. Nëna-roje hante dhe vrojtonte.

— Sh...t...

Vajzës i mbeti luga me supë midis buzëve.

— Sh...t.

Vajzën e trembi shikimi i s'ëmës. Sytë e saj fare papritur ishin ndezur, ishin gjallëruar shumë. Vajza pa njëherë rrëth e qark, si për të diktuar se ku humbi në atë sallë gjithë zhurmë mërzitja e s'ëmës.

Nëna vuri gishtin tregues mbi buzë, duke lëshuar një sh...sh... të padëgjueshme nëpër dhëmbë e duke hapur kapakët e syve sa më s'mbanin.

Bëri veshët bigë e si pa kuptuar shtyu trupin mbrapa.

— Po ore në Tiranë, në Ministri do shkoka...

— Inxhiner i zoti, besa.

— Edhe djalë i dashtun...

Vajzës as që i arrinë në vesh këto fjalë, që

këmbenin dy malësorë të ulur në tryezën mbas tyre, por e ëma i kapte të gjitha e s'i shpëtonte asgjë.

— Asht nga familje e mirë — tha njëri nga malësorët.

Nëna i shkeli syrin vajzës, duke përkulur kokën pérpara, kurse ajo ngriti supet.

— Ja se ku qenka, qe, bashkë me shokët...

— tha malësori tjetër e tregoi me kokë një nga tryezat në krye të sallës, rrëth së cilës ishin ulur nja shtatë-tetë djem të rinj.

Edhe nëna ktheu kokën. Kundroi një çast pastaj iu drejtua së bijës.

— Ai do jetë, ai bruni vetullimbërthyer, që po qesh e s'e mban dot gazin... alamet djali qenka...!

— Mjeku i ri, që pritej të vinte dje? — pyeti e pasigurt vajza.

— Ç'jmjek moj! Fati, — fati me krahë që po na vjen si me porosi.

— Ndonjë mik?

— A dhe ti... — Ajo ktheu një herë kokën mbrapa pér t'u bindur se s'po e dëgjonte njeri, pastaj u përkul mbi tryezën, i bëri shenjë së bijës që të afronte veshin e i tha duke pëshpëritur:

— Është inxhinier, — i ka ardhur transferimi pér në Tiranë. — Në Ministri, dëgjon, në Ministri... — dhe s'e përmbajti dot emocionin, atë emocion që ndjen roja kur kap një «peshk» të madh.

— Unë kam shpresë të madhe. Qenka nga familje e mirë. Kjo është kryesorja, bijë, dhe Tirana, pa të tjerat rregullohen. Kështu nga kashta të marka në qafë... Shikoje, shikoje, vec... me marifet.

Vajza meqjithëse nuk e aprovonte veprimin e s'ëmës i hodhi një shikim pa interes atij, që ishte ulur përballë tyre, në tryezën në krye të sallës. Atë çast djaloshi ndezi cigaren, e vajza dalloi rrethin e florinjtë në dorën e tij të majtë.

— Qënka i martuar — tha padashur dhe i erdhi turp që s'e mbajti dot gjuhën. Shikimi i s'ëmës ndryshoi aty për aty. Ktheu kokën dhe pa unazën me sytë e saj. Ajo i ngjau si një hallkë që e kish mbërthyer për gryke dhe i merrte frymën.

Përsëri as u pa se nga doli mërzitja, që u ul mbi kapakët e syve të saj dhe ja puliti, ushqimi mezi i kalonte në fyt se ishte pérzier me copa psherëtimash të ashpra.

Heshtje në qoshen e tyre të ndarë me mure të padukshme, heshtje si në guackën e kërmillit.

Roja hante veten me dhëmbë që kishte gabuar.

Kafshonte bukën gjithë inat, sikur të kafshonte mërazin ndaj vetëvetes. Por meqjithatë detyrën s'e harroi.

— Inxhinier, gëzuar... Të na zbardhësh faqen asaj Tirane... Mos na harro... — çau muret e heshtjes një urim nga qoshja tjeter e sallës. Nëna përsëri vuri gishtin mbi buzë. Nga tryeza që u bë pikë vrojtimi për të u çua një djalë njëzet e shtatë - njëzet e tetë vjeç me gotën e rakisë në dorë:

— As mos të shkojë ndër mend se do të të harroj, o Mark.

— Qenka tjeter — tha nëna.

— Bëra shaka, o inxhinier, se e di që ne miq kemi qenë e miq do të mbetemi — foli ai që uroi.

Nëna i vërejti duart.

— Ky qënka beqar — i pëshpëriti së bijës.
Ajo vazhdonte të hante në heshtje.

— Xhanan djalë.

— Asht mërzitë që po largohet.

— U mësue këtu e u ba si djalë vendi — bisedonin malësorët në tryezën fqinje.

— Edhe ky goxha djalë — i tha së bijës e ëma.

Ajo s'e ngriti kokën nga pjata.

— E kur po nisesh, o inxhinier? — pyeti ai i tryezës në qoshen tjetër.

Nëna u bë e gjitha veshë.

— Mbas një ore, sa të kthehet Gjoka prej sektorit.

Nënës... edhe e shtëna e dytë i doli bosh.
Lëshoi një Uf...f... të gjatë e të thellë.

Përsëri heshtje në qoshen e tyre, një heshtje që asaj i digjite trupin, e vajzës i ngrinte nervat.

E kështu pra, inxhinieri iku në Tiranë i pacënuar nga të shtënat e rojes.

Nëna vazhdoni të rrrijë e strukur qosheve.

Dhe jo vetëm në hotel, restorant apo kinema ato kishin qoshen e tyre. Nëna krijoi një qoshe portative, që ato e merrnin me vete në çdo hap, si kërmilli guackën e vet, një qoshe të thurur nga shikimet dhe mendimet e saj e të mbuluar me autoritet të padiskutueshëm (të paktën kështu i dukej). Pra, kështu ka ardhur ajo në qytetin tonë. Mirëpo në malet tona flladet janë të forta; të forta janë edhe flladet e jetës sonë, të humorit tonë, ato e godasin nga çdo drejtëm qoshen që endet në gjirin e tyre. Nëna s'do t'ja dijë përkëto goditje, kurse vajza i ndjen ato, ajo e sheh se si këto fllade i ngrenë këndet e qoshes së tyre

dhe i thith flladet tonë. Për këtë ajo ha gjithmonë qortimet e heshtura të mamakës, por ato s'i djegin më si më parë, bille nganjëherë e gudulisin e ajo mezi e mban të qeshurën.

Nëna tani është bërë më e heshtur dhe ka filluar të shkruajë shpesh. Po bëhet klientja më e rregullt e postës. Po çfarë shkruan nëpër letrat? Për këtë edhe e bija ngrinte supet. Një ditë u bë kurioze dhe, ndërsa e ëma flinte, hapi komodinën e saj dhe nxori tri letra që nëna i kishte futur në zarf po akoma s'i kishte mbyllur. I levoi. I drejtoheshin disa kushërinje, që ajo s'e dinte në i kishin të katërt apo të pestë dhe s'ua mbante mend fytyrat.

Përveç emrit të letërmarrësit gjithshka në të tria letrat ishte e përbashkët, thuajse si kopje të së njëjtës letër të shaptilografuar, si ato që u dërgojnë nganjëherë disa redaktorë bashkëpunëtorëve të tyre.

...ju lutem, po patët rast na gjeni ndonjë djalë të mirë për Lizzën. Kuptohet, që të jetë në Tiranë, të ketë disi një punë që... ju e dini vetë. Për të tjerat shihni e bëni, po kryesoret këto janë. Kjo është rrugë e fundit për ne. Ju përqafoj me mall së largu.

E juaja përgjithmonë
Tefta

Liza sa nuk ja dha gazit me të madhe, sepse iu kujtua se si, para disa muajsh, njëri nga këta kushërinj kishte shkuar në shtëpinë e tyre me të shoqen dhe nëna s'ua kishte hapur derën, duke dërguar fëmijën e një fqinji që t'u thoshte se nuk ishte aty.

Liza mori lapsin dhe mendoi të shkruante në fund të letrave:

«*Nëna bën shaka.*» Por ndërroi mendim... Ajo e donte shumë të ëmën dhe e kishte të vësh-tirë që të bëhej shkak pér ta mërzitur. Megjithatë i erdhi rëndë që puna kishte arritur deri këtu... I grisi letrat. Përsëri pati grindje me të ëmën që mos e vazhdonte më këtë korrespondencë. Kjo mundohej t'i mbushte mendjen, kurse ajo e vrarë shpirtërisht pëshpëriti me vete... — Dy në dorë... prite, prite të madhen... Megjithatë nëna vazhdoi të shkruante përditë letra e thurte tërkuzë mendimesh, që i niste në drejtime të panjohura pér të zbuluar rrugën e fundit, pér të gjetur dhëndrrin, që do t'i shpëtonte nga... Ajo i ka vënë shumë epitete qytetit tonë, e unë s'di cilin të zgjedh. Pér shëmbull në letrat ajo shkruan «*kemi ardhur ku ha pula gurë*». Dhe e shpjegon se nuk e ka fjalën pér gurët e vërtetë, por pér gurët e jetës. Unë them se ne hamë bukë gruri, gaz e të qeshura përditë. Kurse kërmilli në qoshe rron vetëm, duke ngrënë mërzitjen e vet.

Diku kishte shkruar: «*Kemi ardhur aty ku dielli më parë perëndon se lind*». I jap edhe unë të drejtë, e ka goditur bukur! Pér ato që janë në qoshe vërtet që është e vështirë të dallojnë lindjen nga perëndimi.

Qoshen lëvizëse të qytetit tonë tani e shohin

dhe e njobin të gjithë, kurse krijuesia e saj, të cilën tani e thérresin: «Zonja me lugë në çantë», sheh vetëm vetëveten, të bijën dhe imazhin e një rruge të padukshme, që të çon në Tiranë. Në krye të kësaj rruge ajo dallon siluetën e dhëndrrit me tiparet e inxhinierit tonë, që shkoi në Ministri.

Po të vini në qytetin tonë dhe po të jeni kureshtarë për ta njobur atë, kërkojeni në dhomën numër 19, në fund të korridorit të hotelit.

Po s'e gjetët aty shkoni në restoran dhe hidhni sytë në tryezën e qoshes në të majtë. Po s'e gjetët as aty shkoni në farmaci. e do ta gjeni pa tjetër, struktur në qoshen e vet, ndërsa vajzën vërejeni me kujdes e do ta shihni se si do të përshëndesë buzëgaz një djalosh, që do të duket mbas pak në farmaci e kur ai do të kërkojë aspirina, do të shikoni kur ajo t'i fusë një letër në tabletë.

Ndërsa roja në karakollin e saj vigjelon symbyllaz, ruan qoshen, pa e parë të bijën që ka dalë prej saj.

Dhe thur tërkuza, që këputen pa dalë te dera.

Dhe pret përgjigjen e letrave, që i ka marrë era.

Dhe kërkon rrugën që ja kanë humbur, rrugët e tjera.

PASQYRA E LENDÈS

	Faqe
Baballarët	3
Shi	9
Shkrimtari	13
Kapistalli	19
Fejtoni	27
Armiku i klasës	32
Në udhë	37
Hasmi	41
Urata	52
Për ato të qoshes	62